



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
në "Inxhinieri agrare", profili "Hortikulturë"
i
Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti "Fan S.
Noli", Korçë"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Aleko Miho

2. Prof.asoc. Valbona Sota

Muaji/Viti

Dhjetor 2021

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit me karakter Profesional në “Menaxhim Veteriner” ofruar
nga Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Agronomisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	"Inxhinieri agrare", profili "Hortikulturë"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR nr. 389, datë 10.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr. 62, datë 09.04.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Master Profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Personeli akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9 PAE/0 PAK v.a. 2020-2021 9 PAE/0 PAK v.a. 2019-2020
18	Numri i studentëve:	12 Studentë v.a. 2020-2021 28 Studentë v.a. 2019-2020
19	Komente / të tjera:	

Albino *F. S. Noli*

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional (1 vjeçar; 60 kredite) në "Inxhinieri agrare", profili "Hortikulturë", Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, prej v.a. 2018-2019 përgatit ekspertë të lartë me njohuri të përparuara veçanërisht në hortikulturë dhe zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja është në përputhje me drejtimit akademike të Fakultetit të Bujqësisë, dhe Departamentit të Agronomisë si përgjegjës të drejtpërdrejtë, struktura dhe përvoja e të cilëve trashëgohet prej Institutit të Lartë Bujqësor (themeluar në vitin 1971). Programi zhvillohet nga një personel akademik dhe ndihmësakademik i kualifikuar dhe me përvojë të gjatë në fushën e bujqësisë, si në mësimdhënje, në kërkim dhe në njohjen me praktikën më të mira bujqësore; mbështetet nga një infrastrukturë mësimore dhe kërkimore e bollshme, mirëpajisur dhe funksionale, me salla leksionesh, seminaresh, me 9 laboratore, me një Ekonomi bujqësore Didaktike Eksperimentale (EDE; 19 ha) etj.; mbështetet edhe nga bashkëpunime me QTTB, Korçë, dhe me sipërmarrje të ndryshme bujqësore në Qark.

Vlerësimi i GVJ në tërësi është pozitiv për Programin. Edhe pse i ri, është shumë në përputhje me nevojat sot në sektorin e bujqësisë, sektor kryesor i zhvillimit ekonomik në Qarkun e Korçës, dhe në gjithë vendin. Ne jemi të bindur se Institucioni i ka të gjitha mundësitë për përmirësime, konkretisht: rishikimin e planit mësimor; peshën e laboratorëve dhe të praktikës profesionale; të punës së diplomës; të numrit të lëndëve për semestër; ngarkesën mësimore të personelit akademik; rekrutimin e personelit të ri; sigurimin e cilësisë së brendshme dhe raportimin përkatës; informacion në faqen e internetit në përdorim nga jashtë; etj. Të gjitha në përputhje me aktet tona ligjore, me kërkesat në vend, por dhe me përvojën e bollshme ndërkombëtare në rajon dhe më gjerë. Ne mbështesim si shumë të dobishëm zhvillimin e një Plani mësimor si të tillë, por ndoshta me kohëzgjatje më të madhe, deri në 2 vite gjithsej.

GVJ konstaton se Programi kërcënohet nga ulja e cilësisë dhe vetëmbyllja prej zvogëlimit të numrit të studentëve në hyrje, cilësisë së dobët të tyre, dhe prej mungesës së personelit të ri akademik me përvojën e duhur. Këshillohet mbështetje për kandidatë cilësorë për këto programe, si dhe motivim më shumë të personelit akademik, sidomos të personelit të ri, kjo në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor, dhe atë qendror.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

GVJ pati në përbërje Prof. Aleko Miho, ekspert i biologjisë së ruajtjes (botanikë), Universiteti i Tiranës, dhe Prof.asoc. Valbona Sota, eksperte e bioteknologjisë bimore, UT. Ekspertët e jashtëm kryen fillimisht një kualifikim të shpejtë pranë ASCAL, ku u njohën me ecurinë e vlerësimit të Programit dhe Dosjen e nevojshme të përgatitur nga Njësia përgjegjëse dhe ngarkuar nga UNIKO në faqen e-ASCAL. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit Grupi u asistua dhe nga MSc. Erjon Xhako, Sektori i Promocionit dhe Vlerësimit të Cilësisë në ASCAL.

GVJ shqyrtoi me kujdes materialet para dhe pas vizitës në Institucion. RVB ishte mbështetja kryesore, jo vetëm për të njohur gjendjen, por edhe si udhëzues për t'u njohur me materialet në Dosje dhe për t'u thelluar më tej në njohjen e Programit, të vlerave dhe shqetësimeve. Takimet me palët në UNIKO u organizuan në 2 ditë, dt. 18 dhe 19 Tetor 2021. Në ditën e parë u zhvilluan takime: me Rektorin e UNIKO; Dekanin e FB; Përgjegjësin e DA; me Grupin e RVB; me personelin akademik; me Studentët e Programit; me Drejtorinë e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor; me Koordinatorin e projekteve Erasmus+; etj. Në ditën e dytë u organizuan takime: me përfaqësues të Qendrës së Karrierës dhe Alumni dhe Qendrës Rinore dhe Sportive; me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit; me Sekretarinë mësimore; u bënë vizita në mjediset (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.); në Bibliotekë; dhe në fund sërish u bë një takim përmbyllës me Përgjegjësin e Departamentit të Agronomisë. Më pas në Tiranë secili prej nesh mori gjithë kohën e duhur për përpilimin e këtij Raporti, duke e kaluar në mënyrë të ndërsjellë te njëri-tjetri për të njësuar formën dhe përmbajtjen, vlerësimin përkatës, deri te analiza SWOT në fund, dhe më pas përcjelljen në ASCAL.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Inxhinieri agrare", profili "Hortikulturë", Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë "Master profesional" në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional (1 vjeçar; 60 kredite) në "Inxhinieri agrare", profili "Hortikulturë", Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, në përputhje me qëllimet dhe misionin e Institucionit, me fushën përkatëse të veprimtarisë, dhe sidomos në përputhje dhe nxitje të zhvillimit ekonomik vendas dhe/ose kombëtar. Këto kritere përmbushen, dhe janë të shkruara në Nenin 2, dhe Kreun III të Statutit të UNIKO (2018). Përsëriten edhe në Draft statutin në proces miratimi në Nenet 2 & 3 dhe në Kreun VI, në Rregulloren e UNIKO (2018), Neni 3, Pika 2, dhe Nenet e Kreut VI. Gjithashtu, këtë e përforcon edhe informacioni dhe fryma në Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO (2016-2020) dhe Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO (2021-2026) ¹ . Mbi shikueshmërinë e këtyre dokumenteve nga jashtë në faqen zyrtare të UNIKO (https://www.unkorce.edu.al/) shih komentet tona në Standardin IV.5, Kriteri 6.
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	
	Programi përgatit ekspertë të lartë me njohuri të përparuara për teknologjitë e zbatuara në pemëtar, vreshtari, perimtari dhe zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor ² , në përputhje me nevojat sot në sektorin e bujqësisë. Duhet theksuar se sektorët e Bujqësisë dhe Turizmit janë sektorët kryesorë të zhvillimit ekonomik në Qarkun e Korçës, dhe në shumë qarqe të tjera të Shqipërisë. Një konstatim i tillë zë vend vetëm në dokumentat e brendshme që lidhen me Programin, si në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit ³ , në studimin e bërë enkas për Tregun e Punës ⁴ nga DA për këtë Program,

¹ SHTOJCA 1.1 STATUTI I UK.PDF; SHTOJCA 1.1.1 DRAFTSTATUTI I NDRYSHUAR I UNIVERSITETIT FAN S. NOLI .pdf; SHTOJCA 1.2 RREGULLORJA E UK.PDF; SHTOJCA 1.3 PLANI STRATEGJIK UNIKO 2016-2020.PDF; + SHTOJCA 1.3.1 DRAFT PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIKO.pdf

² +RVB INXHINIERI AGRARE.PROFILI HORTIKULTURE 2021.pdf

³ SHTOJCA 2.4 PLANI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E PROGRAMIT NJËSISË.pdf

⁴ SHTOJCA 3.12 STUDIM TREGU PUNE PERIODIK NË KUADËR HAPJEJE PROGRAMI STUDIMI.pdf

si dhe në Rregulloret e Departamentit të Agronomisë (DA) dhe të Fakultetit të Bujqësisë (FB)⁵.

Por GVJ konstaton se një frymë e tillë pozitive për Sektorin e Bujqësisë nuk është e dukshme jo vetëm në faqen e UNIKO, por as në dokumentet e hostuara në faqet e Këshillit të Qarkut, dhe të Bashkive përkatëse⁶, pavarësisht nga gjallimi tradicional në vite i këtij Sektori në gjithë këtë rajon.

Edhe pse i ri, GVJ konstaton se Programi kërcënohet nga ulja e cilësisë dhe vetëmbyllja prej zvogëlimit të numrit të studentëve në hyrje, cilësisë së dobët të tyre, dhe prej mungesës së personelit të ri akademik me përvojën e duhur. Si edhe shumë programe të tjera bujqësore në UNIKO dhe gjetkë, ky Program po mundohet të mbijetojë me shumë vështirësi në tregun shqiptar ndaj konkurrencës së programeve të 'superkërkuara' që janë aktive në shumë nga IAL-të në vend, përfshirë dhe në UNIKO. Kjo është në dëm të fuqizimit dhe qëndrueshmërisë së Programit, edhe pse përmbush nevojat me ekspertë të kualifikuar për një sektor jetik të vendit.

Në gjithë Qarkun ka vetëm një shkollë të mesme, Shkolla e Agrobiznesit "Irakli Tërova", Korçë, me profile në bujqësi dhe veterinari, që përgatit specialistë të mesëm të bujqësisë për zonën. Mendojmë se kjo nuk mjafton për gjithë këtë Qark të gjerë, jo vetëm për të furnizuar vazhdimisht dhe mjaftueshëm me specialistë të mesëm të kualifikuar, dhe kjo jo vetëm në degë të agrobiznesit, por më gjerë në degët e bujqësisë dhe veterinarisë, por edhe si ushqim me kandidatë për specialistë të lartë të bujqësisë për degët bachelor dhe master të Fakultetit të Bujqësisë së këtij Institucioni.

Jo vetëm në Programin në fjalë, por në gjithë programet e FB na u konstatua se ka një mungesë të theksuar me kandidatë që kërkojnë të vazhdojnë të ndjekin degët e bujqësisë; edhe kandidatët që afrohen për të ndjekur studimet janë përgjithësisht jo cilësorë (me mesatare të ulët) madje një degë bachelor që përgatiste specialistë të lartë të Hortikulturës, si pararendëse e Programit nën shqyrtim, nuk është aktive prej disa vitesh.

E gjithë kjo qasje shpërfillëse ndaj Sektorit të Bujqësisë, ndaj peshës që ka në zhvillimin e Rajonit, dhe të tjera që ne do të theksojmë në vijim, jo vetëm kërcënon mbajtjen aktive të këtyre Programeve, pavarësisht nga cilësia e mirë e tyre, por është me pasoja në zhvillimin si duhet të rajonit në Sektorin e Bujqësisë në të ardhmen. Këshillojmë që Drejtuesit e FB, të UNIKO, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Qarkut dhe të katër Bashkitë kryesore, ta shohin me shumë seriozitet dhe me frymë mbështetëse këtë mangësi që krijon sot zhvillimi relativisht i verbër i këtij Rajoni, si dhe në

⁵ SHTOJCA 2.2 RREGULLORE E NJËSISË KRYESORE FAKULTETI I BUJQËSISË.PDF; SHTOJCA 2.3 RREGULLORE E NJËSISË BAZË AGRONOMI.PDF

⁶ <https://www.korcaregion.com/>; <https://www.bashkiakorces.gov.al/site/>; <https://bashkiapogradec.gov.al/>; <https://www.kolonja.gov.al/home/>; <https://www.bashkiadevoll.gov.al/>

	<p>shumë rajone të tjera të vendit. Kjo duke gjetur dhe mbështetur praktika pozitive për tërheqjen e kandidatëve drejt kualifikimit në degët e bujqësisë, duke filluar nga mbështetja dhe fuqizimi i shkollave të mesme të profilit bujqësor, nga mbështetja me bursa studimi i kandidatëve cilësorë (me mesatare të lartë) që vazhdojnë degët e bujqësisë etj.</p> <p>Ne shprehim se për këtë Institucioni ashtu si dhe për disa Institucione të tjera që ne kemi qenë për vlerësim, nuk do përbënte kurrë përparësi hapja dhe tejmbushja me kandidatë e degëve jo në përparësi për zhvillimin, p.sh. dega e Infermierisë⁷ në UNIKO dhe gjetkë. Kjo padyshim është në dëm të degëve tradicionale të sektorit të bujqësisë në rastin e UNIKO!</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Edhe këto kritere përmbushen për Programin nën shqyrtim (Emërtimi, Struktura dhe Përmbajtja), duke përmbushur kërkesat e shkruara në Nenin 2, dhe Kreun III të Statutit të UNIKO (2018). Përsëriten edhe në Draft statutin ⁸ në proces miratimi në Nenet 2 & 3 dhe në Kreun VI, në Rregulloren e UNIKO (2018), Neni 3, Pika 2, dhe Nenet e Kreut VI. Gjithashtu, Programi është në përputhje me informacionin dhe frymën e Planit Strategjik të Zhvillimit të UNIKO (2016-2020) dhe Planit Strategjik të Zhvillimit të UNIKO (2021-2026), si dhe kërkesat e Rregullores së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë ⁹ . Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e Programit është në përputhje me fushat e drejtimit akademike të Njësisë Kryesore ¹⁰ , Fakultetit të Bujqësisë (FB), dhe Njësisë Bazë, Departamentit të Agronomisë ¹¹ (DA).
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Programi përgatit ekspertë të lartë me njohuri të përparuara për teknologjitë e zbatuara në pemëtar, vreshtari, perimtari dhe zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor ¹² , në përputhje me nevojat sot
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të	

⁷ <https://moodle.unkorce.rash.al/course/index.php?categoryid=17&browse=courses&perpage=20&page=0>

⁸ + SHTOJCA 1.1.1 DRAFTSTATUTI I NDRYSHUAR I UNIVERSITETIT FAN S. NOLI .pdf

⁹ + SHTOJCA 1.5 RREGULLORE E DREJTORISË SË KURRIKULAVE (NJSBC, QKA).PDF

¹⁰ SHTOJCA 2.2 RREGULLORE E NJËSISË KRYESORE FAKULTETI I BUJQËSISË.PDF

¹¹ SHTOJCA 2.3 RREGULLORE E NJËSISË BAZË AGRONOMI.PDF

¹² +RVB INXHINIERI AGRARE.PROFILI HORTIKULTURE 2021.pdf

institucionit.	në sektorin e bujqësisë, si një nga sektorët kryesorë të zhvillimit ekonomik në Qarkun e Korçës dhe gjithë Shqipërisë. Të gjitha këto janë në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.			
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Megjithatë, edhe këtu GVJ rithekson komentet e bëra në Standardin I.1, Kriteri 4, lidhur me një qasje sa më pozitive ndaj Sektorit të Bujqësisë, jo vetëm nga Institucioni, por nga gjithë aktorët e rëndësishëm në Rajon, Këshilli i Qarkut, dhe Bashkitë përkatëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimit "Master profesional" synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit "Master profesional" kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	<p>Programi, ka karakter profesional. Ai zhvillohet në një vit akademik me 60 kredite, dhe synon në formimin e agronomëve të kualifikuar për teknikat dhe teknologjitë e e reja dhe të përparuara, veçanërisht në Hortikulturë (pemëtari, vreshta dhe luletari).¹³ Në Planin Mësimor¹⁴ të Programit janë gjithsej 13 lëndë: 2 lëndë të kategorisë A, 6 lëndë të kategorisë B, 5 lëndë + 2 lëndë me zgjedhje të kategorisë C, si dhe 2 javë Praktikë Profesionale (50 orë) dhe 8 kredite Punë Diplome (200 orë ose 4 javë). Nga 760 orë gjithsej, 188 orë (rreth 25%) janë laboratore, të cilave u shtohen edhe 250 orë të Praktikës Profesionale dhe Punës së Diplomës.</p> <p>Kjo është në përputhje me nivelin e studimeve dhe me kërkesat e tregut të punës. GVJ konstaton përmbushjen e këtij Kriteri në Rregulloren e Programit (Shtojcat 2.5), në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit¹⁵, në studimin e bërë enkas për Tregun e Punës¹⁶ nga DA për këtë Program, si dhe në Rregulloret e Departamentit të Agronomisë (DA) dhe të Fakultetit të Bujqësisë (FB) (Shtojcat 2.2 & 2.3). Kjo u konstatua edhe nga vizita jonë në Institucion, njohja me Personelin, me Mjediset laboratorike dhe të Praktikës. Megjithatë, disa komente dhe këshillime lidhur me Planin Mësimor dhe përmbajtjen në të rësi të Programit jepen në Standardin II.1.</p>

¹³ +RVB INXHINIERI AGRARE.PROFILI HORTIKULTURE 2021.pdf

¹⁴ SHTOJCA 2.7 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT (1VIT).pdf

¹⁵ SHTOJCA 2.4 PLANI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E PROGRAMIT NJËSISË.pdf

¹⁶ SHTOJCA 3.12 STUDIM TREGU PUNE PERIODIK NË KUADËR HAPJEJE PROGRAMI STUDIMI.pdf

<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Në Dosje gjendet një studim i bërë enkas për Tregun e Punës¹⁷ nga DA për këtë Program. Po ashtu në RVB pohohet se studimi i tregut të punës vendas dhe ndërkombëtar me bëhet periodikisht nga Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) e UNIKO, e cila ka ndërtuar një Bazë të Dhënash¹⁸ të studentëve të diplomuar dhe të institucioneve punëdhënëse. Kjo bëhet nëpërmjet një Pyetëtori¹⁹ për studentët e diplomuar. Këto të dhëna i dërgohen njësisë bazë (DA) dhe INSTAT për punësimin e të diplomuarve të tyre. Ato ndihmojnë edhe DA për përcaktimin e kuotave të pranimit. GVJ e konstatoi këtë edhe nga vizita në Institucion, njohja me QKA, dhe me veprimtarinë e DA.</p> <p>Duhet thënë se ekziston vetëm një degë Bachelor (180 Kredite) në Inxhinieri Agrare, me profil në Hortikulturë, në Universitetin Bujqësor i Tiranës, tashmë akredituar nga ASCAL deri në 2025 (Vendim BA 84/2019). Nuk jemi në dijeni për zhvillimin e një MP të ngjashëm në IAL-të në Shqipëri.</p> <p>Në të vërtetë, sipas studimit të Tregut të Punës, dhe ajo që ne njohim për Qarkun e Korçës, Sektori i Bujqësisë, dhe në veçanti i Hortikulturës është i lartë, dhe në rritje. Por nga të dhënat e QKA (Shtojca 4.6), nga 16 të diplomuar në Hortikulturë, vetëm 3 kanë deklaruar në pyetësor, dhe vetëm 1 prej tyre është i punësuar. Shumica e të diplomuarve (13 të diplomuar) nuk i janë përgjigjur pyetësorit. Duket se kjo mënyrë e ndjekjes së punësimit dhe e vlerësimit të tregut të punës nuk funksionon sa duhet. GVJ këshillon të gjenden mënyra të kombinuara për të gjetur qoftë kërkesat reale të tregut të punës, qoftë bashkëpunimet me bizneset e sektorit të bujqësisë në Rajon, dhe më gjerë në Shqipëri, për cilësinë e të diplomuarve, për praktika profesionale dhe më pas. Megjithatë, edhe këtu GVJ rithekson për një qasje sa më pozitive ndaj Sektorit të Bujqësisë, jo vetëm nga Institucioni, por nga gjithë aktorët e rëndësishëm në Rajon, Këshilli i Qarkut, dhe Bashkitë përkatëse (<i>shih</i> komentet në Standardin I.1, Kriteri 4).</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe</p>	<p>GVJ mendon se ky Kriter përgjithësisht përmbushet, por me komentet që jepen në Standardin II.1. Kjo nga shqyrtimi me hollësi i Planit Mësimor²⁰, i Syllabuseve²¹ lëndore, nga Rregullorja²², nga Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit²³, Modeli i Diplomës²⁴, si dhe kontaktet me Personelin, Studentët etj.</p>

¹⁷ SHTOJCA 3.12 STUDIM TREGU PUNE PERIODIK NË KUADËR HAPJEJE PROGRAMI STUDIMI.pdf

¹⁸ SHTOJCA 4.6 TABELA PËRMBLEDHËSE PËR PUNËSIMIN E STUDENTËVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.pdf

¹⁹ https://forms.office.com/Pages/ResponsePage.aspx?id=i2QCKSe5g001uJDOc7_ggc3ChvLFY9BOi9JKb7s4rQ9UMFIBRkQyNTNUMEiCVzFVMk9KVk1GRzIJMi4u

²⁰ SHTOJCA 2.7 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT (1VIT).pdf

²¹ SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LËNDORE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT (SYLLABUSET).pdf

²² SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL" NË "INXHINIERI AGRARE, PROFILI HORTIKULTURË" 2020-2023..pdf

²³ SHTOJCA 2.4 PLANI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E PROGRAMIT NJËSISË.pdf

²⁴ SHTOJCA 2.6 MODELI I DIPLOMËS SË PROGRAMIT TË STUDIMIT.pdf

lehtësojnë punësimin e studentëve.	
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Nga kërkimet tona në WEB, Master në Hortikulturë zhvillohet nga shumë universitete evropiane, amerikane dhe më gjerë.²⁵ Një pjesë e mirë zhvillohen në 2 vite, pak në 1.5 vite. Masterat 1 vjeçarë në Europë janë të pakët, dhe të shumtë në Amerikë. P.sh. mastera 1 vjeçarë zhvillohen për Europën: në Writtle University College, Angli (por me 180 Kredite të alternuara), në University College Dublin, Irlandë (por me 90 Kredite); për Amerikën në: Washington State University, Ohio State University, Cornell University, Texas A&M University, Texas Tech University, North Dakota State University, Rutgers University, Newark, New Jersey, Utah State University, Oklahoma State University, University of California, Davis, University of Minnesota, University of Nebraska-Lincoln, Michigan State University, University of Georgia, Kansas State University, University of Maine, Auburn University, Colorado State University, etj.</p> <p>GVJ e pati të vështirë të gjejë shkallën e përafritimit të programeve lëndore me këto Programe të ngjashme të ofruara nga institucionet ndërkombëtare. Në RVB nuk thuhet gjë konkretisht lidhur me përputhshmërinë që ka Programi me ndonjë Program të ngjashëm të ofruar nga ndonjë institucion ndërkombëtar. Nuk jemi shumë të bindur për shkallën e transferimit të studimeve; por mendojmë se të diplomuarit e aftë në këtë Program nuk e kanë të vështirë punësimin në tregun ndërkombëtar.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Masteri në shqyrtim përputhet me kërkesat e Masterit profesional (Master i nivelit të parë) të Nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK, 2014), të cilat mendojmë se janë në përputhje me legjislacionin në fuqi (VKM 41/2017) dhe direktivat e BE, mbështetur kjo edhe në të dhënat në Rregulloren e Programit (Shtojcat 2.5), në RVB të FB²⁶, dhe gjithë informacioni shtesë në Dosjen përkatëse në ASCAL.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë "Master profesional" përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>GVJ mendon se ky Programi përgjithësisht përfshin aftësim profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e Programit, si dhe në direktivat ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. Por edhe këtu ne ritheksojmë komentet dhe këshillat e dhëna në Standardin II.1, lidhur me ngarkesën lëndore të Programit, ngarkesën e leksioneve në disa lëndë, ngarkesën e Praktikës në Terren dhe Punën e Diplomës.</p>

²⁵ <https://www.masterstudies.com/MSc/Horticulture/>; <https://www.masterstudies.com/Masters-Degree/Horticulture/Europe/?page=2>; <https://www.mastersportal.com/search/master/horticulture/europe/>; <https://www.mastersportal.com/search/master/horticulture/united-states>

²⁶ SHTOJCA 3.7 RAPORTI VJETOR I NJSBC FAKULTETI I BUJQËSISË.PDF

<p>Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>RVJ nuk konstaton se ka lëndë ose module që mund të zhvillohen në gjuhë të huaj. Kjo si në Rregulloren e Programit, dhe në Syllabuset²⁷ lëndore. Mendojmë se kjo është një çështje shumë aktuale dhe Departamenti duhet të rishohë mundësinë e zhvillimit të mësimt edhe në gjuhë të huaj, angleze, ose tjetër gjuhë me interes për tërheqjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>			
<p>Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimt të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Nuk është rasti i këtij Programi. GVJ mendon se zhvillimi i këtij Programi përbush një kërkesë të përhershme, në një sektor shumë të rëndësishëm për Qarkun e Korçës, për të kualifikuar në fushën e hortikulturës, për institucione të rëndësishme të fushës, si AREB, ARSHVMB, AKU, QTTB etj. (<i>shih</i> edhe komentet në Standardin I.1, Kriteri 4).</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi I.4</p>	
<p>Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njesisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti i Korçës “F.S.Noli” është themeluar rreth 30 vite më parë (VKM 230/1992)²⁸ dhe akredituar nga ASCA¹, me Vendim të BA 65/2017 deri në 30/09/2022²⁹. Fillesat nisin që me Institutin e Lartë Bujqësor i themeluar në vitin 1971; deri në 1992 janë diplomuar 1,210 specialistë të bujqësisë. Në vitin akademik 2020-2021 UNIKO ka gjithsej 3,334 studentë gjithsej, të pranuar 1,338 dhe të diplomuar 1,341. Mban Urdhërin “Naim Frashëri” (2001) dhe dekoratën “Nderi i Kombit” (2015). Vlen të theksojmë se UNIKO kryen veprimtarinë në Qytetin e Korçës, qytet që dallohet në vend për traditat historike arsimdashëse.</p> <p>Sot UNIKO ka 4 fakultete, 15 departamente dhe 28 njësi administrative. Në vitin 2015 është akredituar me 5 vjet (VBA 65/2017) (Shtojca 1.3.1)³⁰. Këtu bëjnë pjesë edhe Fakulteti i Bujqësisë dhe Departamenti i Agronomisë, përgjegjës për Programin e Studimit MP në Inxhinieri Agrare, profile Hortikulturë. UNIKO ka sot rreth 155 punonjës si personel akademik, me 6 profesorë, 28 profesorë të asociuar, 78 doktorë (5 PhD), 4 docentë, 39 MSc. Ka gjithashtu rreth 136 punonjës si taf akademik me kontratë (të</p>

²⁷ SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LËNDORE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT (SYLLABUSET).pdf

²⁸ + SHTOJCA 1.3.1 DRAFT PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIKO.pdf

²⁹ <https://www.ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara>

³⁰ + SHTOJCA 1.3.1 DRAFT PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIKO.pdf



	<p>jashtëm). UNIKO zhvillon ka sot rreth 60 Programe studimi (54 aktivë dhe 6 jo aktivë) (Shtojca 1.3.1) të miratuara, 7 programe profesionale (2 vjeçare), 26 BA, 21 MP, 3 MS, 1 PhD; 9 prej tyre të akredituar nga ASCAL, dhe 13 në proces akreditimi.</p> <p>UNIKO ka 127 marrveshje ndërkombëtare me partnerë homologë në vendet e Ballkanit dhe Europës (Shtojca 1.3.1); është pjesë e rrjeteve <i>ASCEC, AUF, UNIMED, AURORA CDS, dhe BALKAN UNIVERSITY ASSOCIATION</i>; është pjesë e 11 projekteve ndërkombëtare Erasmus+ KA2, dhe 4 marrveshje mobilitetesh Erasmus+ KA1. Ka Bibliotekë të ndarë në 5 mjedise, për secilin Fakultet, me 30,000 libra dhe 12,000 tituj gjithsej, dhe lidhje me rrjetet digjitale <i>ProQuest</i> dhe <i>U Library</i>, të cilat ofrojnë <i>online</i> 170,000 libra dhe 70 milionë tituj publikimesh të ndryshme.</p> <p>Ka 9 laboratorë mësimorë dhe shkencorë (Shtojca 1.3.1), ku bëjnë pjesë laboratorët e Agrokimisë, Pedologjisë, Kimisë dhe Kimisë Analitike, Biologjisë dhe Biologjisë Molekulare, dhe Informatikës, Mbrojtjes së Bimëve, Pemtarisë, Perimtarisë dhe Fitoteknisë, të gjithë këta me rëndësi në zhvillimin e Programit nën shqyrtim. DA bashkëpunon me Ekonominë Didaktike Eksperimentale (EDE)³¹ me sipërfaqe prej 19 ha, direkt nën varësi të UNIKO, me bazën e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), Korçë, dhe me sipërmarrje të ndryshme me drejtim bujqësor³².</p> <p>Nga sa më sipër GVJ mendon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për programin e studimit, sipas k'asifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fakulteti i Bujqësisë, përgjegjës për zhvillimin e Programit, është në përbërje të UNIKO që nga themelimi (1992³³). Madje FL është vazhdim i Institutit të Lartë Bujqësor, i cili vepronte më parë në Korçë që nga viti 1971. Fusha e studimit, përcaktohet qartë në Rregulloren e Fakultetit³⁴, në RVB të Fakultetit³⁵, e njëjtë me atë të Departamentit të Agronomisë³⁶. Kjo përvojë shumëvjeçare shoqërohet edhe nga një personel i kualifikuar dhe me përvojë³⁷.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë,</p>	<p>GVJ konstaton se fusha e Programit është shumë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, Departamentit të Agronomisë, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane, konkretisht me Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë (VKM 531/2018)³⁸ dhe</p>

³¹ + SHTOJCA 1.8 RREGULLORE E DREJTORISË FINANCIARE (EDE).PDF

³² +RVB INXHINIERI AGRARE.PROFILI HORTIKULTURE LINK.pdf

³³ SHTOJCA 2.18 SHKRESA PËR HAPJEN E FAKULTETIT TË BUJQËSISË.pdf

³⁴ SHTOJCA 2.2 RREGULLORE E NJËSISË KRYESORE FAKULTETI I BUJQËSISË.PDF

³⁵ SHTOJCA 3.7 RAPORTI VJETOR I NJSBC FAKULTETI I BUJQËSISË.PDF

³⁶ SHTOJCA 4.13 FUSHAT E STUDIMIT NË DEPARTAMENTIN E AGRONOMISË.pdf

³⁷ SHTOJCA 4.1 TABELA E PERSONELIT AKADEMIK TË ANGAZHUAR NË PROGRAMIN E STUDIMIT .pdf

³⁸ <https://www.ascal.al/media/documents/publikime/Kodi-Cilesise-se-Arsimit-te-Larte.pdf>

përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	ISCED 2011, Niveli 7 ³⁹ ; si i tillë ky Master Profesional i përket Kategorisë 757: ‘ <i>Master’s or equivalent level, professional (second or further degree - following successful completion of a Bachelor’s or equivalent programme)</i> ’.			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Nuk është rast i tillë Programi në shqyrtim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e kësaj lloji të arsimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësitë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	DA ka një personel akademik me 8 punonjës, 1 Prof., 4 Prof.asoc. 2 Dr. dhe 1 Msc. Kualifikimi i personelit është në përputhje të plotë me modulet që mbulon Programi. Përgjegjësi i DA ndjek ecurinë e Programit në bashkëpunim me Dekanatin e FB, me Sekretarinë Mësimore të FB, me Drejtorinë e Kurrikulës dhe Vlerësimin Institucional (Shtojca 1.5) etj. DA bashkëpunon me Ekonominë Didaktike Eksperimentale (EDE) ⁴⁰ me sipërfaqe prej 19 ha, direkt nën varësi të UNIKO, me bazën e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), Korçë, dhe me sipërmarrje të ndryshme me drejtim bujqësor ⁴¹ . UNIKO ka marrëveshje bashkëpunimi me Qarkun Korçë, Bashkitë e Korçës,
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi	

³⁹ <http://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/international-standard-classification-of-education-isced-2011-en.pdf>

⁴⁰ + SHTOJCA 1.8 RREGULLORE E DREJTORISË FINANCIARE (EDE).PDF

⁴¹ +RVB INXHINIERI AGRARE.PROFILI HORTIKULTURE LINK.pdf

me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Pogradecit, Devollit, Ersekës dhe Maliqit dhe me institucione të tjera shtetërore (Shtojca 2.10) ⁴² . Mbështetur në këto marrëveshje studentë të Programit kryeinë praktika mësimore dhe profesionale pranë tyre.			
Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	DA ka bashkëpunime edhe me një sërë biznesesh të tjera në fushën e prodhimit të kulturave të ndryshme bujqësore ku zhvillohen pjesa më e madhe e praktikave mësimore dhe profesionale. Këto janë të listuara në Shtojcën 3.5 ⁴³ dhe në Udhëzuesin për Praktikën Profesionale (Shtojca 3.21) ⁴⁴ . Në Shtojcën 3.6 ka një Raport mbi përfitimet e Programit nga bashkëpunimi/marrëveshja me QTTB, Korçë ⁴⁵ . Këtu dokumentohet edhe bashkëpunimi më i gjerë në rajon nëpërmjet bashkëpunimit me QTTB, konkretisht nëpërmjet pjesëmarrjes në projektin e BE për Europën JL, ‘Regional Marketing - Branding of Products and Regions’ ⁴⁶ ; nëpërmjet projektit të BE për vendet e Europës JL, ‘Joung Inovators Network for Sustainable Ideas in the Agro-Food Sector (NO-BLE Ideas)’ ⁴⁷ , në Konferencën Rajonale ‘The ODA of IDEAs’ ⁴⁸ , Ohër, dhe në Tryezën ‘Rurality becomes a value’, Resnie ⁴⁹ .			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	Në RVB përmendet se UNIKO zhvillon kurse kualifikimi për specialistë të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, Korçë, QTTB Korçë, për fermerët kultivues të mollës, patates, fasules etj. të Qarkut Korçë. Kjo do ishte me interes edhe për kualifikimin në vazhdim të diplomuarve në Programin në shqyrtim dhe Programet e tjera të FB.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në RVB përmendet se UNIKO zhvillon kurse kualifikimi për specialistë të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, Korçë, QTTB Korçë, për fermerët kultivues të mollës, patates, fasules etj. të Qarkut Korçë. Kjo do ishte me interes edhe për kualifikimin në vazhdim të diplomuarve në Programin në shqyrtim dhe Programet e tjera të FB.			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	DA harton Raporte ⁵⁰ vjetore për punën mësimore dhe kërkimore të cilën merren në analizë edhe përfitimet nga bashkëpunimet e ndryshme. Kjo në formën e arritjeve në procesin mësimor dhe atë kërkimor (punë diplome, doktorime, publikime dhe pjesëmarrje në konferenca etj.). Lidhur me cilësinë e këtyre Raporteve është komentuar më gjatë në Standardin III.1, Kriteri 2, kurse mbi mungesën e hostimit të tyre në faqen e UNIKO është komentuar në Standardin IV.5, Kriteri 6.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁴² SHTOJCA 2.10 MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NË MBËSHTETJE TË PRAKTIKAVE PROFESIONALE.pdf

⁴³ SHTOJCA 3.5 TABELA E INSTITUCIONEVE BASHKËPUNUESE PËR PRAKTIKAT.pdf

⁴⁴ SHTOJCA 3.21 UDHËZUES PËR PRAKTIKAT PROFESIONALE.pdf

⁴⁵ SHTOJCA 3.6 RAPORTI I PËRFITIMEVE NGA MARRËVESHJET NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.pdf

⁴⁶ http://prespa.seerural.org/wp-content/uploads/2015/10/Application_Branding.pdf

⁴⁷ <http://no-bleideaspace.blogspot.com/2014/08/>

⁴⁸ https://www.youtube.com/watch?v=ldHWZ0CntDA&ab_channel=MarielaStefanllari

⁴⁹ https://seerural.org/wp-content/uploads/2018/12/Prespa-People-to-People-implementation_ABD-5.pdf

⁵⁰ Evidenca I.19- Raporti vjetor i punës mësimore, akademike dhe kërkimore-shkencore në DB, Janar 2018-

Shtator 2019.PDF

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Plani Mësimor i Programit⁵¹ është i organizuar në 13 lëndë gjithsej: 2 lëndë të kategorisë A, 6 lëndë të kategorisë B, 5 lëndë + 2 lëndë me zgjedhje të kategorisë C, si dhe 2 javë Praktikë Profesionale (50 orë) dhe 8 kredite Punë Diplome (200 orë ose 4 javë). Lëndët janë të ndara në Module (Leksione, Seminare ose/dhe Laboratore), të vlerësuara me Kredite gjithsej 60, të cilat zhvillohen brenda 1 viti (2 semestra ose 30 javë mësimore). Programi është i pajisur edhe me Supplementin e diplomës. Gjithë elementët mësimorë synojnë formimin e shprehive agronomike të përparuara në fushën e hortikulturës, si pemëtari, perimtari, lulëtari, bujqësinë e qendrueshme etj.⁵²</p> <p>Nga 760 orë gjithsej, 477 orë janë leksione (rreth 63%), 95 orë janë seminare (12.5%), 188 orë (rreth 25%) janë laboratore; këtyre u shtohen edhe 50 orë të Praktikës Profesionale dhe 200 orë të Punës së Diplomës (33% gjithsej). Tipet e lëndëve, volumi i tyre në kredite dhe shpërndarja e moduleve përkatëse në semestra është përgjithësisht në përputhje me kërkesat e VKM 41/2017.</p> <p>Gjithsesi, GVJ konstaton dy pasaktësi lidhur me volumin e Lëndëve Bazë (A) dhe Lëndëve Plotësuese (D), në përputhje me kërkesat e VKM 41/2017, Shtojca 1, Tabela 1:</p> <p>-Lëndët Bazë (A) – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme, janë gjithsej 8 Kredite (13%). Sipas VKM 41/2017, në Masterin Profesional Lëndët Bazë (A) duhet të kenë një vëllim prej 5%-10% (3-6 kredite);</p> <p>-Praktika Profesionale është e vetmja Lëndë Plotësuese (D) me gjithsej 2 Kredite (3%). Sipas VKM 41/2017 në Masterin Profesional Lëndët Plotësuese (D) duhet të kenë një vëllim prej 10% (6 kredite). Këshillojmë që Praktika Profesionale të shkojë në 6 Kredite, 150 orë ose 6 javë punë në subjektet e</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	

⁵¹ SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL" NË "INXHINIERI AGRARE, PROFILI HORTIKULTURË" 2020-2023..pdf

⁵² SHTOJCA 2.4 PLANI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E PROGRAMIT NJËSISË.pdf

Albino V. Stafa

[Signature]

kontraktuara.

Gjithashtu:

-Në Rregulloren Programit⁵³ thuhet se 740 orë janë jashtë auditorit (Shtojca 2.5, f. 9). Nuk kuptohet se ku janë konkretisht, dhe pse nuk janë pasqyruar në Planin Mësimor.

-Programi mbyllet me veprimtarinë 'Tezë diplome/Provimi diplome', me 8 kredite, e llogaritur me 200 orë (ose 8 javë punë individuale e studentit). Puna e diplomës bëhet vetëm nga kandidatë të zgjedhur me mesatare note gjatë 3 viteve të para bachelor, kurse studentët e tjerë i nënshtrohen 'Provimit'. Kjo nga sa kuptoam edhe nga takimet në DA dhe me studentët zhvillohet në pak javë, jo në 8 javë punë individuale e studentit, sa parashikohet në Plan (200 orë). Për më tepër, nuk del shumë qartë në dokumentacion mënyra si zhvillohet Provimi as në Rregulloren e Programit dhe as në Programet lëndore. Nuk del e qartë në Rregullore nëse Puna e Diplomës është Punë Eksperimentale, apo Punë Teorike, në Kabinet ose Bibliotekë.

GVJ lidhur me Punën e Diplomës këshillon që secili **student të ketë mundësinë e një pune eksperimentale konkrete**, me 8 kredite, e llogaritur me 200 orë (ose 8 javë punë individuale e studentit), në udhëheqjen e një pedagogu dhe në bashkëpunim me subjektet bujqësore të zonës; kjo duhet të jetë në përparsi, ndaj punëve të diplomës me karakter teorik. Mendojmë se **Provimi përfundimtar duhet të shmanget** si i tillë dhe të zëvendësohet vetëm me **Mbrojtje Diplome** nga secili student, e cila është në frymën e kërkesave të Bolonjës, sidomos edhe në frymën e kërkesave të një Masteri Profesional. Veprimtaria 'Tezë diplome/Provimi diplome' në Planin Mësimor të jetë vetëm veprimtarinë 'Tezë diplome'.

-Po në këtë frymë, në disa lëndë të Planit Mësimor mund të rishihet pesha e leksioneve (nga 45 orë leksione në të shumtën 30 orë) në funksion të seminareve dhe sidomos të praktikave laboratorike.

-Si i tillë, Programi me gjithsej 13 lëndë (7+6 lëndë në dy semestra) + Praktikë Profesionale + Punë Diplome/Provimi është relativisht i mbingarkuar. Më shumë nga përvoja mund të themi se kaq shumë lëndë është vështirë të zhvillohen dhe asimilohen si duhet në 30 javë (1 vit). Kjo mund të ngjeshë kohën e duhur për Praktikën Profesionale, dhe Punën e Diplomës, të theksuar më sipër.

Nëse mendojmë dhe mbështesim se mund të ruhet kjo përmbajtje lëndore, por duke rregulluar kërkesat për Praktikën në Terren me 6 Kredite, 150 orë ose 6 javë, dhe Punën e Diplomës me 200 orë ose 8 javë, të cilat sëbashku

⁵³ SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL" NË "INXHINIERI AGRARE, PROFILI HORTIKULTURË" 2020-2023..pdf

	<p>bëjnë 14 javë, pra rreth 1 semester. Kjo për rëndësinë që ka ky Program në tërësinë e tij për ekspertë të kualifikuar të fushën në Qarkun e Korçës. Por ruajtja e një Plani mësimor të tillë kërkon kohëzgjatje më të madhe, ndoshta deri në 2 vite gjithsej. Kjo mund të ulte dhe sasinë e lëndëve në semester deri në jo më shumë se 4-5 lëndë.</p>			
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>GVJ mendon se në tërësinë e tyre këto dy Kritere përmbushen, edhe pse ka nevojë për më shumë, lidhur me cilësinë e Planit Mësimor në tërësi (theksuar më sipër, Standardi II.1, Kriteret 1&2), cilësinë Syllabuseve lëndore (Standardi II.3), rregullimin e ngarkesës së personelit, të numrit të lëndëve, përmirësime në strukturën moshore të personelit, vlerësimin e cilësisë së personelit dhe motivimin e më të mirëve (shih komentet në Standardin II.2), si dhe me përpjekjet e vazhdueshme për të mundur pranime sa më cilësore në vitin e parë.</p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Lidhur me strukturën dhe elementët përbërës të tij, Programi është përgjithësisht në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në përputhje me legjislacionin në fuqi (VKM, 41/2018⁵⁴; VKM 879/2019⁵⁵; U1-MASR/2020)⁵⁶. Programi ka ngarkesat përkatëse të shpërndara sipas elementëve të zhvillimit të njohurive, leksione, seminare, laboratore, praktika dhe Tezë/Provim Diplome.</p> <p>Por këtu duhen ritheksuar komentet që jepen në Standardin II.1, Kriteret 1&2 më sipër, lidhur me rregullimet që duhen bërë në Planin mësimor në përputhje me kërkesat e VKM, 41/2018, si dhe rregullime të tjera në përmbajtjen e Programit lidhur me peshën e seminareve dhe laboratorëve ndaj leksioneve të disa lëndëve, të gjitha këto nën frymën që kërkon një Master Profesional.</p>			
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>				
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>				
<p>Kriteri 7. Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

⁵⁴ VKM-nr.-112-date-23.2.2018-ok

⁵⁵ VKM Nr.879, date 18.12.2019

⁵⁶ Udhezimi-nr.-1-dt.-14.01.2020..pdf

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	FB, UNIKO, është njësi kryesore e strukturuar për të ofruar programe studimi, në përputhje me Ligjin 80/2015, themeluar me VKM 230/1992 dhe akredituar nga ASCAL, me Vendim të BA 65/2017 deri në 30/09/2022 ⁵⁷ . Kjo mbështet edhe në gjithë dokumentat e Strukturës organizative, Statutit dhe Rregullores së UNIKO, si edhe mbi kërkesat ligjore, pranohet se njësi kryesore – Fakulteti i Bujqësisë, si dhe Njësia bazë – Departamenti i Agronomisë përmbushin detyrimet ligjore përkatëse si për organizimin dhe strukturën akademike (FB & DA), dhe për numrin dhe nivelin e kualifikimit (DA). Zhvillimi i Programit koordinohet nga Përgjegjësi i DA, i cili informon vazhdimisht titullarin e FB.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Madje duhet theksuar se FB dhe DA në përbërje të tij janë trung i rëndësishëm i gjithë UNIKO, rrënjët e të cilit zgjaten deri në Institutin e Lartë Bujqësor të themeluar në vitin 1971.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	DA përbëhet nga 9 punonjës akademikë (v.a. 2020-2021) ⁵⁸ , nga të cilët 1 profesor, 5 profesorë të asociuar, 2 doktorë dhe 1 lektor (MSc).
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	DA është përgjegjës për: Programin Profesional (PP) (2 vjeçar; 120 Kredite): Teknika të prodhimit të farave dhe fidanave (TPFF; Vendim 373/2018; aktiv); Programin Bachelor (BA) (3 vjeçar; 180 Kredite): Mjekësi e bimëve & Hortikulturë (MB&H; Vendim 281/2013; aktiv); Programin Bachelor (BA) (3 vjeçar; 180 Kredite): Inxhinieri Agronome (IAG; Vendim 273/2015); Masterin Profesional (MP) (1 vjeçar; 60 Kredite): Inxhinieri Agrare, profili Hortikulturë (IAG&H; Vendim 389/2018; aktiv) (Programi nën shqyrtim) ⁵⁹ .
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	Por nga RVB dhe takimet në Institucion, GVJ konstaton se:
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me	-Edhe për arsyt historike të sipërpërmendura, DA ka personel me përvojë të gjatë si në praktikën bujqësore dhe në mësimdhënie e kërkim shkencor, dhe kualifikimi është në përputhje të plotë me modulet që mbulon ⁶⁰ . Por ka disa arsye që bien ndesh me një zhvillim normal dhe vazhdimësinë e mësimdhënies. Moshë mesatare e personelit është mbi 50 vjeç ⁶¹ ; ngarkesa mësimore e secilit është relativisht e lartë, duke shkuar në disa raste mbi 300 orë në vit, madje

⁵⁷ <https://www.ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara>

⁵⁸ SHTOJCA 4.14 NGARKESA E PLOTË MËSIMORE E STAFIT TË DEPARTAMENTIT TË AGRONOMISË

⁵⁹ SHTOJCA 3.8 ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË SË NJËSISË BAZË.pdf

⁶⁰ SHTOJCA 2.14 KUALIFIKIMET E STAFIT AKADEMIK.pdf; SHTOJCA 2.9 JETËSHKRIMET E STAFIT TË PËRFSHIRË NË PROGRAMIN E STUDIMIT.pdf

⁶¹ +RVB INXHINIERI AGRARE.PROFILI HORTIKULTURE LINK.pdf

objektivat e tij.	<p>në ndonjë rast dhe mbi 400 orë; kjo ngarkesë është e shpërndarë në shumë lëndë, nga 5-7 lëndë⁶². Këto sëbashku, ndikojnë në zhvillimin cilësor, por dhe në vazhdimësinë e mësimdhënies në të 4 degët për të cilat DA është përgjegjës, përfshirë këtu edhe Programin nën shqyrtim. Nga takimet konstatuam se nevoja për të rekrutuar personel të ri ka qënë tepër e vështirë në këta vite, për shkak të mungesës së në kandidatë të rinj cilësorë. GVJ këshillon të rishihet numri i lëndëve dhe i ngarkesës së personelit akademik në përputhje me U29/MASR 2018, dhe të gjejë mundësi për të rekrutuar personel të ri të brendshëm.</p> <p>Lidhur me qasjen pozitive dhe mbështetëse ndaj Sektorit të Bujqësisë dhe degëve të FB, sërish ritheksojmë sa është komentuar në edhe në Standardin I.1, Kriteri 4.</p> <p>-Mësimi në DA mbështetet vetëm nga 1 punonjëse ndihmëse, e cila është edhe në cilësinë sekretares së DA. Pavarësisht nga numri i kufizuar i studentëve në 3 Programet aktive ku DA është përgjegjës, përfshirë dhe këtë Program, përsëri 1 punonjëse (edhe kjo me kohë të kufizuar) na duket shumë pak. Këtu kemi parasysh se janë 9 laboratorë mësimorë dhe shkencorë⁶³, në të cilët zhvillohen paralelisht module laboratorësh nga lëndë të ndryshme. Prania e punonjësve ndihmës rast pas rasti është shumë e dobishme si në zhvillimin normal të çdo seance laboratorit, por dhe në vënien në punë dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, të cilat nga sa vumë re nuk mungonin.</p> <p>-Ka edhe një fakt tjetër që vlen të theksohet për IAL-të publike, për të cilën ne mendojmë se qendron dhe për UNIKO. Kjo është gjendja financiare e Institucionit dhe motivimi i personelit në punë, i lidhur ngushtë me të, përfshirë këtu edhe rekrutimin e personelit të ri. Për këtë është komentuar më gjatë në Standardin IV.6, Kreu 5.</p>			
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.3</p> <p>Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e</p>	<p>Në tërësinë e tyre këto Kritere përgjithësisht përmbushen, dhe</p>

⁶² SHTOJCA 4.2 TABELA E NGARKESËS SË STAFIT AKADEMIK TË ANGAZHUAR NË TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT.pdf

⁶³ + SHTOJCA 1.3.1 DRAFT PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIKO.pdf

studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Dosja e Programit është e plotë, duke filluar nga Rregullorja e Programit ⁶⁴ , Plani Mësimor ⁶⁵ , Syllabuset lëndore ⁶⁶ , Suplementi i Diplomës ⁶⁷ etj. Përmbajtja e Programit rishihet për vit, bëhen përmirësimet e nevojshme dhe miratohet nga Përgjegjësi i DA. ⁶⁸
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Mbi shikueshmërinë e këtyre dokumenteve nga jashtë në faqen zyrtare të UNIKO (https://www.unkorce.edu.al/) shih komentet tona në Standardin IV.5, Kriteri 6.
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	GVJ mendon se ka nevojë për më shumë, lidhur me cilësinë e Planit mësimor në tërësi (theksuar në Standardin II.1 më sipër), rregullimin e Ngarkesës së personelit ⁶⁹ , të Numrit të lëndëve, përmirësimet në Strukturën moshore të personelit, vlerësimin e Cilësisë së personelit dhe Motivimin e më të mirëve (<i>shih</i> komentet në Standardin II.2), si dhe me përpjekjet e vazhdueshme për të mundur Pranime sa më cilësore në vitin e parë.
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Përveç komenteve dhe këshillimeve më sipër mbi Planin Mësimor (Standardi II.1), lidhur me cilësinë Syllabuseve lëndore mendojmë se duhet patur kujdes në saktësimin e literaturës së përdorur, e cila duhet të jetë e shkruar njëlloj për të gjithë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, mundësisht sipas stilit APA ⁷⁰ , më i përdorshmi sot në shkencat e jetës. Po kjo mund të thuhet edhe në shkrimin e literaturës në Jetëshkrimet ⁷¹ dhe Raportimet e FB/DA. ⁷²
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Kjo lehtëson njohjen shpejt me literaturën e përdorur, vitin, shtëpinë botuese, numrin e faqeve etj.
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë	Por ajo që është më e rëndësishme është përditësimi i literaturës në përdorim, recensimi i saj në nënyrë të rregullt dhe të panashëm nga personeli akademik i DA dhe më gjerë, përfshirë këtu edhe Leksionet e shkruara në përdorim. UNIKO ka miratuar edhe një Rregullore ⁷³ për miratim tekstesh mësimore, por ne konstatojmë se përgjithësisht literatura bazë në lëndë të ndryshme përfaqësohet nga tekste apo leksione të shkruara nga tutullarët e lëndëve. Përgjithësisht literatura bazë dhe sidomos ajo

⁶⁴ SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL" NË "INXHINIERI AGRARE, PROFILI HORTIKULTURË" 2020-2023..pdf

⁶⁵ SHTOJCA 2.7 PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT (1VIT).pdf ; SHTOJCA 4.3 TABELA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT QË OFRON NJËSIA BAZË E AGRONOMISË.pdf

⁶⁶ SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LËNDORE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT (SYLLABUSET).pdf; SHTOJCA 3.19 MODEL PROGRAM I SHKURTUAR .pdf

⁶⁷ SHTOJCA 3.20 SUPLEMENTI I DIPLOMËS SË PROGRAMIT TË STUDIMIT.pdf

⁶⁸ SHTOJCA 2.12 PROCEDURA E NDRYSHIMEVE NË PLANIN MËSIMOR (RISHIKIMI I KURRIKULËS).pdf

⁶⁹ SHTOJCA 4.3 TABELA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT QË OFRON NJËSIA BAZË E AGRONOMISË.pdf; SHTOJCA 4.2 TABELA E NGARKESËS SË STAFIT AKADEMIK TË ANGAZHUAR NË TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT.pdf

⁷⁰ <https://www.scribbr.com/apa-style/reference-entry/>

⁷¹ SHTOJCA 2.9 JETËSHKRIMET E STAFIT TË PËRFSHIRË NË PROGRAMIN E STUDIMIT.pdf

⁷² SHTOJCA 3.7 RAPORTI VJETOR I NJSBC FAKULTETI I BUJQËSISË. SHTOJCA 3.8 ANALIZA VJETORE E VEPRIMITARISË SË NJËSISË BAZË.pdf

⁷³ + SHTOJCA 1.12 UDHËZIM PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE MËSIMORE NË NIVEL NJËSIE BAZË.PDF

komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	ndihmëse është jo shumë e re, e botuar mbi 5 vite më parë.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga ky rast, por dhe nga përvoja botimi i teksteve universitarë mbetet një ndër pikat e dobëta të cilësisë së mësimdhënies në IAL-të shqiptare. Përpilimi i teksteve mësimorë në shqip në lëndë të shumta për çdo Program mbetet gjithmonë nismë e pedagogut të lëndës, në shumë raste e financuar prej tij, jo rregullisht e recensuar, ose e përditësuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ mendon se ngarkesa e Programit përgjithësisht është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore, dhe të tregut të punës. Shpërndarja në dy semestra e lëndëve (moduleve përkatëse) dhe praktikave dhe përmbajtja e tyre mundësojnë thellim të njohurive, të aftësive në çështje të ndryshme të hortikulturës, në përshtatje me kërkesat e tregut e punës dhe punësimin. Përmbajtja e Programit rishihet për vit, bëhen përmirësimet e nevojshme dhe miratohet nga Përgjegjësi i DA. ⁷⁴
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësitimit profesional.	Por edhe në këtë Standard, GVJ mendon se ka nevojë për më shumë, lidhur me cilësinë e Planit mësimor në tërësi (theksuar në Standardin II.1 më sipër), rregullimin e Ngarkesës së personelit akademik ⁷⁵ , të numrit të lëndëve, përmirësimet në strukturën moshore të personelit, vlerësimin e cilësisë së personelit dhe motivimin e më të mirëve (Standardin II.2), si dhe me përpjekjet e vazhdueshme për të mundur pranime sa më cilësore në vitin e parë ⁷⁶ . Sërish ritheksojmë si edhe në Standardin I.1, Kriteri 4, lidhur me qasjen pozitive dhe mbështetëse ndaj Sektorit të Bujqësisë. Ritheksojmë se përditësimi i literaturës në përdorim, recensimi i saj në mënyrë të rregull dhe të panashëm, përfshirë këtu edhe Leksionet e shkruara në
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive	

⁷⁴ SHTOJCA 2.12 PROCEDURA E NDRYSHIMEVE NË PLANIN MËSIMOR (RISHIKIMI I KURRIKULËS).pdf

⁷⁵ SHTOJCA 4.3 TABELA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT QË OFRON NJËSIA BAZË E AGRONOMISË.pdf; SHTOJCA 4.2 TABELA E NGARKESËS SË STAFIT AKADEMIK TË ANGAZHUAR NË TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT.pdf

⁷⁶ SHTOJCA 4.4 TABELA E TË DHËNAVE TË REGJISTRIMIT DHE ECURISË SË STUDENTËVE NË HYRJE DHE DALJE.pdf

formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	përdorim, e shtjelluar më gjatë në Standardin II.3, Kreu 4.			
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.				
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.				
Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.				
Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Edhe për këtë Standard, GVJ mendon se përgjithësisht përmbushen gjithë kriteret për personelin akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon Programin e studimit, si në kualifikimin akademik dhe atë profesional. Personeli akademik që mbulon Programin e studimit përbëhet nga 9 punonjës (v.a. 2020-2021) ⁷⁷ , nga të cilët 1 profesor, 8 profesorë të asociuar; 6 punonjës janë nga DA dhe 3 të tjerë përkatësisht nga departamentet e Agrobiznesit dhe të Agroushqimit, po nga FB, INUKO ⁷⁸ .
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të	

⁷⁷ SHTOJCA 4.14 NGARKESA E PLOTË MËSIMORE E STAFIT TË DEPARTAMENTIT TË AGRONOMISË

⁷⁸ SHTOJCA 4.1 TABELA E PERSONELIT AKADEMIK TË ANGAZHUAR NË PROGRAMIN E STUDIMIT .pdf

<p>studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Por edhe në këtë Standard, GVJ mendon se duhen ritheksuar sa është shkruar në Standardin II.2 lidhur me personelin akademik, Moshën mesatare, Ngarkesën mësimore⁷⁹, Numrin e lëndëve, Vlerësimin dhe Motivimin e më të mirëve, si dhe Pranimet jo cilësore në degët e bujqësisë⁸⁰, në FB, përfshirë dhe në Programin nën shqyrtim. Këto sëbashku, ndikojnë në zhvillimin cilësor, por dhe në vazhdimësinë e mësimdhënies në të 4 Programet për të cilat DA është përgjegjës.</p>			
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ këshillon të rishihet numri i lëndëve dhe i ngarkesës së personelit akademik në përputhje me U29/MASR 2018, për të mirën e cilësisë së mësimdhënies. Ndoshta kjo vjen edhe nga paqartësi të U29/2018 lidhur me kufirin maksimal të orëve mësimore në vit që një punonjës akademik mund të kryejë brenda institucionit të vet plus jashtë institucionit, si dhe mungesës së rregullave të unifikuara për normimin e saktë të gjithë punës vjetore në një IAL. Për shembull nëse një punonjës me kohë të plotë me titullin profesor zhvillon një ngarkesë mësimore të plotë me 140 orë brenda institucionit të vet (ndonjëherë edhe mbinormë), si mund të justifikohet të zhvillojë edhe një normë deri 120 orë mësimi si punonjës i ftuar ose me kohë të pjesme në një institucion tjetër? Si rregull mbinorma mësimore nuk duhet të kalojë mbi 30% në total (brenda dhe jashtë institucionit) në se duhet që punonjësit efektivë të kenë më shumë kohë për punë shkencore (diploma, doktorata, projekte etj.). Është kjo kohë dhe përkushtim që sjell përmirësim edhe në mësimdhënie.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Këtu ne sërish ritheksojmë si edhe në Standardin I.1, Kriteri 4 dhe Standardin II.2, lidhur me qasjen pozitive dhe mbështetëse ndaj Sektorit të Bujqësisë. UNIKO duhet të vendosë në përparësi degët e bujqësisë ndaj disa degëve të tjera, të gjejë mundësinë të mbështesë me bursa studimi kandidatë cilësorë (me mesatare të lartë) në degët e bujqësisë, pse jo dhe motivimi më shumë i personelit etj.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Pavarësisht nga numri i kufizuar i studentëve në 3 Programet aktive ku DA është përgjegjës, përfshirë dhe këtë Program, përsëri 1 punonjës (edhe ky me kohë të kufizuar) na duket shumë pak. Prania e punonjësve ndihmës rast pas rasti është shumë e dobishme si në zhvillimin normal të çdo seance laboratorike, por dhe në vënien në punë dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, të cilat nga sa vumë re nuk mungonin.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

⁷⁹ SHTOJCA 4.3 TABELA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT QË OFRON NJËSIA BAZË E AGRONOMISË.pdf; SHTOJCA

4.2 TABELA E NGARKESËS SË STAFIT AKADEMIK TË ANGAZHUAR NË TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT.pdf

⁸⁰ SHTOJCA 4.4 TABELA E TË DHËNAVE TË REGJISTRIMIT DHE ECURISË SË STUDENTËVE NË HYRJE DHE DALJE.pdf

Standardi II.6				
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	<p>Për këtë Standard, GVJ mendon se kriteret përmbushen përgjithësisht, nga sa shohim nga dokumentacioni në Dosje dhe nga bisedat me studentët gjatë vizitës në Institucion. Në mbështetje dhe prej Statutit të UNIKO (Neni 69)⁸¹, studentët marrin pjesë në diskutimet e ndryshme në DA, të përfaqësuar nga të zgjedhur nëpërmjet Qeverisë Studentore.</p> <p>DA bashkëpunon me bazën e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), Korçë, dhe me sipërmarrje të ndryshme me drejtim bujqësor. UNIKO ka marrëveshje bashkëpunimi me Qarkun Korçë, Bashkitë e Korçës, Pogradecit, Devollit, Ersekës dhe Maliqit dhe me institucione të tjera shtetërore (Shtojca 2.10)⁸². Po ashtu, Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), përgatit Panairin e Karrierës dhe ndërmer kontakte me institucione të ndryshme dhe grumbullon informacion rreth integritit të studentëve, marrëdhëniet me biznesin, ofertat për punësimin e studentëve, orientimin e të diplomuarve për punësim dhe mban kontakte me ta (deri në pesë vjet).</p>			
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.				
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.				
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj, institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

⁸¹ + SHTOJCA 1.1 STATUTI I UK.PDF

⁸² SHTOJCA 2.10 MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NË MBËSHTETJE TË PRAKTIKAVE PROFESIONALE.pdf; SHTOJCA 3.5 TABELA E INSTITUCIONEVE BASHKËPUNUESE PËR PRAKTIKAT.pdf, SHTOJCA 3.21 UDHËZUES PËR PRAKTIKAT PROFESIONALE.pdf



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
<p>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Zhvillimi dhe përdorimi i metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në UNIKO është i sanksionuar në Statut (Shtojca 1.1), në Rregulloren e veprimtarisë mësimore-kërkimore (Kreun VII; Shtojca 1.2) në Udhëzuesin për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies (Shtojca 3.24), si dhe Rregulloren e Programit (Shtojca 2.5)⁸³ etj. Nga vizita në Institucion konstatoam se FB ka një infrastrukturë të kënaqshme për mësimdhënie dhe kërkim, ku përdoren metoda inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në RVB pohohet se cilësia dhe siguria monitorohet nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional (Shtojca 1.5). Si del nga Raportet vjetore të UNIKO, DA dhe Raporti i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FB nga NJSBC⁸⁴ kjo merret në analizë për vit, ku bëhen konstatime të arritjeve në mësim dhe kërkim, evdientohen mangësi dhe shqetësime, dhe jepen këshillime dhe detyra për përmirësim në të ardhmen. Në RVB pohohet se në FB, DA dhe nga përfaqësues të Rektoratit organizohen kontrolle për zbatimin e çdo programi mësimor. Për gjithë personelin akademik efektiv dhe me kontratë ka një Dosje e disiplinuar nga një Udhëzim⁸⁵ i posaçëm, që përmban informacion pranë zyrës së Burimeve Njerëzore dhe pranë DA, e cila ripërtërihet çdo vit (me Jetshkrimin, Syllabuset, Materialet Didaktike etj.)</p> <p>Duhet thënë se Raportet e analizës vjetore në Dosjen ASCAL, sidomos ai i NJSBC mund të strukturohen më mirë, më qartë, duke filluar nga përmbajtja dhe formatimi, duke evidentuar më qartë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira, qoftë për FB, për DA, apo për anëtarë të caktuar të personelit akademik. Kjo do të ndihmonte realisht dhe konkretisht në gjithë procesin e përmirësimit të programit të studimit, dhe përpilimin e planit të masave përkatëse. Nuk del në këta Raporte se cilat janë konkretisht gjetjet nga kontrollet e bëra,</p>

⁸³ SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL" NË "INXHINIERI AGRARE, PROFILI HORTIKULTURË" 2020-2023..pdf

⁸⁴ SHTOJCA 3.29 ANALIZA VJETORE UNIKO.pdf; SHTOJCA 3.7 RAPORTI VJETOR I NJSBC FAKULTETI I BUJQËSISË; SHTOJCA 3.8 ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË SË NJËSISË BAZË.pdf

⁸⁵ + SHTOJCA 1.14 UDHËZIMI PËR PËRMBAJTJEN E DOSJES SË STAFIT UK.PDF

	<p>qoftë pozitive dhe negative, apo rezultatet nga pyetësorët me studentët. Dy prej të cilëve janë në Dosje (Shtojcat 3.13 & 3.14)⁸⁶.</p> <p>Mbetet gjithmonë sfidë përdorimi i treguesve më të qartë, më të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, përfshirë dhe shikueshmërinë e veprimtarisë në rrejetet shkencore ndërkombëtare. Kjo do të pasqyronte më mirë gjendjen, arritjet, por dhe do të nxiste për më shumë. Mbi bazën e treguesve cilësorë të matshëm, institucioni mund të bëjë edhe promovime nxitëse për arritjet më të mira. Kjo mund të institucionalizohet në Rregulloren e UNIKO, dhe Rregulloret e tjera në varësi. Kjo frymë normimi e cilësisë së punës për fat të keq mungon jo vetëm në UNIKO, por në gjithë IAL-të e vendit.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në RVB pohohet se në përfundim të çdo semestri si rregull bëhen anketime me studentët lidhur me aftësitë në mësimdhënie dhe performancën e personelit akademik (Shtojca 3.14), të cilat bëhen publike. Në Dosje është edhe një model analize i zhvillimit të një moduli në fund (Shtojca 3.17), ku jepet rezultati i analizës së një Moduli. Nuk konstatohen të dhëna të tjera mbi këtë lloj analize, apo mbi pyetësin e studentit, dhe ndonjë lloj diskutimi mbi këto të dhëna. Këshillojmë, që si të dhënat e Anketimit të studentëve, dhe ato të Analizës së zhvillimit të një moduli në fund të mund të shqyrtohen në DA, të nxirren prej tyre mangësitë dhe arritjet rast pas rasti dhe mësimet e duhura për të ardhmen.</p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Në RVB pohohet se rezultatet e monitorimit të janë pjesë e Raporteve vjetore të UNIKO, DA dhe të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të cilët gjenden në Dosjen ASCAL. Por GVJ nuk është i qartë nëse ato bëhen publike dhe në çfarë mënyre.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në Raportet vjetore të UNIKO, DA dhe Raporti i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FB nga NJSB nuk dokumentohet se në ç'mënyrë institucioni promovon shembujt më të mirë. GVJ këshillon gjetjen dhe zbatimin e mekanizmave sa më të drejtë dhe nxitës, por dhe të institucionalizuara në Rregulloren e Drejtorisë së Kurrikulave (NJSBC, QKA)⁸⁷.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

⁸⁶ SHTOJCA 3.13 MODEL PYETËSORI STUDENTOR.pdf Erjon Xhako/28.09.2021 10:51

SHTOJCA 3.14 MODEL PYETËSORI I STAFIT AKADEMIK.pdf

⁸⁷ + SHTOJCA 1.5 RREGULLORE E DREJTORISË SË KURRIKULAVE (NJSBC, QKA).PDF

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Thuajse të gjitha këto forma gjenden në Programin mësimor dhe Rregulloren e Programit, si edhe reflektohen në Planin mësimor dhe në Syllabuset lëndore të Programit të studimit. Vlen të ritheksojmë komentet tona lidhur me përmirësime në Planin Mësimor (Standardi II.1), në Syllabuset e lëndëve dhe Tekstet mësimore (Standardi II.3 & III.3, Kriteri 4).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Në RVB theksohet se personeli akademik nxit dhe ndjek punën e pavarur të studentëve, nëpërmjet detyrave dhe projekteve në semestrin e dytë. Këtë gjë mund ta pohojmë edhe nga shqyrtimi i dosjes (jeshkrimet e personelit, projektet etj.) dhe nga vetë kontaktet tona me personelin akademik dhe sidomos me studentët. Programi përfshin laboratorë, detyra dhe projekte kursi, praktika profesionale etj. Personeli akademik i programit ka një shkallë të lartë kualifikimi në fushën që mbulon programi; 100% e personeli është që angazhohet në mësimdhënie në këtë program i përket kategorisë “Profesor” (Shtojca 4.1)⁸⁸. Pjesëmarrja në programet që mbështeten nga BE, si dhe shkëmbimet si në rastin e programit Erasmus+ (Shtojca 4.9)⁸⁹, ka ndikuar në nivelin e kualifikimit dhe përvojën e personelit akademik të programit për mësimdhënie. Realizimi i praktikave mësimore kryhet pranë Qendrës EDE, Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, sipërmarrjeve bujqësore në bimët e arave, vreshta, serra, pemëtore, fidanishte, prodhimi i luleve dhe bimëve dekorative etj. Cilësia e mësimdhënies është objekt vlerësimi dhe diskutimi në analizat vjetore të punës mësimore e shkencore të departamentit⁹⁰.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Në RVB dhe nga kontaktet tona në Institucion mund të pohojmë se kjo mbështetje konsiston në: sigurimin e infrastrukturës së nevojshme; sigurimin e mjeteve të nevojshme didaktike-teknologjike dhe laboratorike; mbështetjen e praktikave në terren; mbështetjen për konferenca; për pjesëmarrjen në në aktivitete kërkimore; pjesëmarrjen në projekte; në mobilitetet të personelit akademik dhe studentëve jashtë shtetit etj.⁹¹</p>

⁸⁸ SHTOJCA 4.1 TABELA E PERSONELIT AKADEMIK TË ANGAZHUAR NË PROGRAMIN E STUDIMIT .pdf

⁸⁹ SHTOJCA 4.9 MOBILITETE STAF STUDENT.PDF

⁹⁰ SHTOJCA 3.8 ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË SË NJËSISË BAZË.pdf

⁹¹ SHTOJCA 4.7 TABELA E TË DHËNAVE INFRASTRUKTURORE NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.pdf;

SHTOJCA 4.8 TABELA E TË DHËNAVE PËR KUALIFIKIMIN DHE KËRKIMIN SHKENCOR.pdf; SHTOJCA 4.9

MOBILITETE STAF STUDENT.PDF

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Mbështetur në RVB, Raportet e Analizës së Punës Vjetore, Raportin e Performancës së personelit akademik, si dhe nga diskutimet me personelin akademik dhe studentët, mund të thuhet se kërkesa e këtij Kriteri përmbushet. Por GVJ ka theksuar më sipër: nevojën për më shumë, lidhur me rregullimin e ngarkesës mësimore vjetore; të numrit të lëndëve; vlerësimin e cilësisë së personelit akademik; motivimin e më të mirëve; rekrutimin e personelit të ri; mundësinë e shtimit të punonjësve ndihmës etj. (shih komentet në Standardin II.5)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Mbështetur në Raportet e Analizës së Punës Vjetore, në Raportin e Performancës së personelit akademik, si dhe nga diskutimet me personelin akademik dhe studentët, mund të thuhet se edhe kërkesa e këtyre tre Krieteve përmbushen. Lidhur me cilësinë e Raporteve të analizës dhe përmirësime është foluar në Standardin III.1, Kriteri 2.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>				
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.3</p>	
<p>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe vizita në Institucion konstatohet se procesi mësimor e shkencor lidhur me Programin zhvillohet brenda mjediseve me hapësira të mjaftueshme, cilësore, të pastra, dhe të mirëmbajtura.⁹²Bëhet fjalë për 2766 m² (salla leksionesh, seminaresh, laboratorë, biblioteka etj.) për rreth 700 studentë të FB, me 3.9 m² për student, dhe 370 m² për 33 punonjës mësimorë, ose</p>

⁹² + SHTOJCA 1.15 RAPORTI I KONTROLLIT TË KAPACITETEVE TË MASR.PDF; SHTOJCA 4.7 TABELA E TË DHËNAVE INFRASTRUKTURE NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.pdf

<p>Kriteri 2. Mjediset e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>11.2 m² për person, të gjitha në përputhje me kërkesat e VKM 418/2017, Aneksi I, Pika C⁹³. Sipërfaqet e këtyre mjediseve janë të mjaftueshme dhe të pajisura me elementët logjistikë të nevojshëm për realizimin normal të procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Sipas RVB dhe nga takimet konstatuam se personeli akademik si edhe studentët, përfshirë edhe ata të që ndjekin Programin, shfrytëzojnë infrastrukturën e FB, ku përfshihet edhe infrastruktura IT dhe Sistemi elektronik (ESSE3)⁹⁴ i vlerësimit gjithëvjetor dhe përfundimtar të studentëve. Nëpërmjet këtij sistemi mundësohet informimi në kohë reale i studentëve lidhur me rezultatet e tyre. Megjithatë, GVJ konston se lidhja përkatëse nuk ishte ne funksion. Më shumë komentojmë në Standardin IV.5, Kriterin 6.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Në Syllabuse vihet re se literatura e përdorur në lëndë të ndryshme është përgjithësisht me tekste ose leksione të shkruara nga secili pedagog përgjegjës. GVJ rithekson përditësimin e literaturës në përdorim, recensimin e saj në mënyrë të rregull dhe të panashëm, përfshirë këtu edhe Leksionet e shkruara në përdorim, e shtjelluar më gjatë në Standardin II.3, Kriteri 4.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>UNIKO ka Bibliotekë të ndarë në 5 mjedise, për secilin Fakultet, me 30,000 libra dhe 12,000 tituj gjithsej, dhe lidhje me rrjetet digjitale <i>ProQuest</i> dhe <i>U Library</i>, të cilat ofrojnë online 170,000 libra dhe 70 milionë tituj publikimesh të ndryshme. Në Dosje është një dokument me të dhëna për Bibliotekën e FB⁹⁵ me një fond me 2210 libra (të karakterit bujqësor, blegtoral dhe ekonomik), 1540 në gjuhën shqipe dhe 670 në gjuhë të huaj. Ka 108 studentë të regjistruar nga 700 që ka gjithë Fakulteti. Ka një Sallë leximi dhe një Punonjëse shërbimi.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Nuk ka të dhëna në Dosje që dokumentojnë se si është cilësia e titujve të librave që lidhen me Programin (p.sh. viti), dhe sa shfrytëzohet fondi i Bibliotekës, dhe sa vende ulur ka Salla e leximit dhe shfrytëzohet nga personeli dhe studentët Programit. Kjo ka rëndësi për të parë se sa të efektshme kanë qënë hapësirat ekzistuese dhe blerjet, dhe cilat janë kërkesat për hapësira dhe për tituj librash.</p> <p>Nga sa ne kuptojmë, Biblioteka funksionon vetëm në orarin zyrtar normal të administratës, vetëm 5 ditë të javës, ora 08.00-16.00. Nga përvoja jonë, Bibliotekat në IAL-të perëndimore, sidomos sallat e leximit kanë gjithmonë orar të zgjatur (ndonjëherë deri në 22.00), përfshirë edhe ditën e shtunë.</p>

⁹³ VKM, Nr. 418, datë 10.5.2017, f. 8

⁹⁴ <https://www.unikorke.esse3.u-gov.rash.al/>; + SHTOJCA 1.5 RREGULLORE E DREJTORISË SË KURRIKULAVE (NJSBC, QKA).PDF; + SHTOJCA 1.6 RREGULLORE E ESSE 3.PDF; + SHTOJCA 1.6.1 MARRËVESHJE RASH PËR ESSE3.pdf

⁹⁵ SHTOJCA 4.10 TË DHËNA PËR FONDIN E LIBRAVE NË BIBLIOTEKË (NË FUNKSION TË PROGRAMIT .pdf

<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>FB ka 9 laboratorë mësimorë dhe shkencorë⁹⁶, ku bëjnë pjesë laboratorët e Agrokimisë, Pedologjisë, Kimisë dhe Kimisë Analitike, Biologjisë dhe Biologjisë Molekulare dhe Informatikës, Mbrojtjes së Bimëve, Pemtarisë, Perimtarisë dhe Fitoteknisë, të gjithë këta me rëndësi në zhvillimin e Programit nën shqyrtim. DA bashkëpunon me Ekonominë Didaktike Eksperimentale (EDE)⁹⁷ me sipërfaqe prej 19 ha, direkt nën varësi të UNIKO, me bazën e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), Korçë, dhe me sipërmarrje të ndryshme me drejtim bujqësor⁹⁸.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Sipas RVB dhe nga takimet konstatuam se personeli akademik si edhe studentët, përfshirë edhe ata të që ndjekin Programin, shfrytëzojnë infrastrukturën infrastrukturën e IT dhe Sistemin elektronik (ESSE3)⁹⁹ të vlerësimit gjithëvjetor dhe përfundimtar të studentëve. Nëpërmjet këtij sistemi mundësohet informimi në kohë reale i studentëve lidhur me rezultatet e tyre. Kjo përvojë është fuqizuar dhe përsosur më tej nga gjithë periudha e pandemisë Covid që jemi të gjithë duke kaluar prej rreth 2 vitesh.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>ESSE3¹⁰⁰ përfaqëson një sistem të integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve në ndihmë të studentëve, duke filluar nga aplikimi në Universitet, jeta universitare deri në mbrojtjen përfundimtare të diplomës. Sistemi ESSE3 përdoret nga studentët, pedagogët dhe sekretaret dhe është i mbrojtur nga ndërhyrjet e jashtme. Studenti pajiset menjëherë me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin për llogarinë e tij; monitoron studimet që nga çasti i aplikimit deri në diplomim. studentët njinen me procedurat e vlerësimit të djeve dhe aftësive të tyre dhe parapërgatit studentët për lëndët dhe modulet si provim me gojë, me shkrim, me gojë dhe me shkrim, për mënyrën e zhvillimit të provimit përfundimtar etj. Në sistem përfshihet i gjithë dokumentacioni i hartuar nga pedagogët në lidhje me vlerësimin e studentëve, përfshirë dhe pikët e vlerësimit gjatë vitit. Në sistem është përfshirë edhe sistemi i pagesave të tarifave me bankë dhe pagesave për shërbime të ndryshme. Për secilin përdorues ka një udhëzues të veçantë për përdorimin e modulit përkatës. Mirëmbajtja e sistemit bëhet nga Sektori i IT, i cili dhe pasqyron çdo informacion për t'i publik. Sistemi është lehtësisht i aksesueshëm në distancë dhe nga çdo aparat elektronik smart që posedohet nga studentët.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe</p>	<p>RVG mendon se ky Kriter përmbushet, por me komentet e Standardit II.1 lidhur me veprimtarinë 'Tezë diplome/Provimi diplome'¹⁰¹, në Planin Mësimor. Puna e diplomës bëhet vetëm nga</p>

⁹⁶ + SHTOJCA 1.3.1 DRAFT PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIKO.pdf

⁹⁷ + SHTOJCA 1.8 RREGULLORE E DREJTORISË FINANCIARE (EDE).PDF

⁹⁸ +RVB INXHINIERI AGRARE.PROFILI HORTIKULTURE LINK.pdf

⁹⁹ <https://www.unikorce.esse3.u-gov.rash.al/>

¹⁰⁰ SHTOJCA 1.6 RREGULLORE E ESSE 3.PDF; SHTOJCA 4.15 MANUALI I PËRDORIMIT TË FAQES ZYRTARE WEB

UNIKO .PDF

¹⁰¹ SHTOJCA 3.28 PËRFSHIRJA E STUDENTËVE NË PUNË SHKENCORE.pdf

mbështet në zhvillimin e tyre.	kandidatë të zgjedhur me mesatare note gjatë 3 viteve të para bachelor, kurse studentët e tjerë i nënshtrohen 'Provimit'. GVJ rithekson se secili student është mirë të ketë mundësinë e një pune eksperimentale konkrete , në udhëheqjen e një pedagogu dhe në bashkëpunim me subjektet bujqësore të zonës; kjo duhet të jetë në përparsi, ndaj punëve të diplomës me karkater teorik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në UNIKO funksionon Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional, me Sektorin përkatës, që menaxhon Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Këto struktura veprojnë mbi bazën e Manualit të Cilësisë ¹⁰² , në të cilin janë përcaktuar të gjithë elementët e sigurimit të cilësisë dhe përmbushjes së standardeve. DA është përgjegjësi kryesor për cilësinë e mësimdhënies në Program, duke monitoruar rregullisht procesin e mësimdhënies dhe të vlerësimit të studentëve dhe e analizon atë periodikisht. Autoritetet drejtuese të FB dhe DA monitorojnë cilësinë e mësimdhënies dhe angazhojnë personelin dhe studentët në hartimin e dokumentave/aktiviteteve të mëposhtme: Kërkesa buxhetore; Analiza vjetore në DA; Aktiviteti kërkimor shkencor në DA; Trajnimet periodike të personelit; Tërheqja e kërkesave/mendimeve të studentëve; Pyetësori i studentëve; Këshillimi akademik; Zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies etj.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Lidhur me këto struktura dhe Raportet përkatëse mund të ritheksojmë edhe sa kemi pohuar në Standardin III.1, Kriteri 2. Këta Raporte duhet të strukturohen më mirë dhe më qartë në përmbajtje dhe formatim. Duhet të evidentohet qartë vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, duke dalluar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira, për secilën njësi kryesore, dhe njësi bazë përkatëse. Kjo do të ndihmonte realisht dhe konkretisht DA dhe personelin akademik përkatës në gjithë procesin e përmirësimit të Programit të studimit, dhe përpilimin e planit të masave përkatëse. Po ashtu ritheksojmë për tregues më të qartë dhe më të matshëm, mundësisht të institucionalizuara
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	

¹⁰² + SHTOJCA 1.16 MANUALI I CILËSISË UK 2020 .PDF

	edhe në rregulloret përkatëse të institucionit, përfshirë këtu për edhe promovimin e arritjeve më të mira, dhe arritjet nga njëri vit në tjetrin etj.			
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Personeli akademik dhe ai ndihmësakademik kanë kryer kurse të ndryshme trainimi brenda dhe jashtë vendit. Puna kërkimore e shkencore, si dhe veprimtaria botuese jepet në Raportet e analizës vjetore të DA (Shtojca 3.8) si dhe në formularët e plotësuar për këtë qëllim (Shtojca 2.15).			
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Në RVB theksohet, por dhe nga takimet në Institucion u konstatua se Personeli është i angazhuar për përmirësimin e mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të reja në mësimdhënie. Këto janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve në analizat vjetore në DA.			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Megjithatë nuk është e lehtë që kjo të konstatohet në dokumentacionin në Dosje, qoftë në kualifikimin në vazhdim të personelit, apo për përmirësimin dhe zbatimin e metodave të reja në mësimdhënie. Edhe këtu ritheksojmë atë që theksuam më sipër edhe lidhur me cilësinë e Raporteve të vlerësimit¹⁰³. GVJ rithekson se ka shumë rëndësi dhe përdorimi i treguesve sa më të matshëm, mundësisht të institucionalizuar, përfshirë këtu edhe mundësinë e promovimit të arritjeve më të mira, por edhe raportimi si duhet i arritjeve, mangësive dhe maseve për përmirësim.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.				
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Nuk u konstatua një gjë e tillë si në RVB dhe gjatë takimeve në institucion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të

¹⁰³ SHTOJCA 3.8 ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË SË NJËSISË BAZË.pdf; SHTOJCA 3.7 RAPORTI VJETOR I NJSBC FAKULTETI I BUJQËSISË.PDF

njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret, mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve përcaktohen në rregullore të veçanta, si në Rregulloren e organizimit të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të UNIKO (Shtojca 1.2), dhe në Rregulloren e organizimit të veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore në FB (Shtojca 2.2), Rregulloren e brendshme të DA (Shtojca 2.3) dhe Rregulloren e vetë Programit. Në fillim të çdo semestri, titullarët lëndëve i orientojnë studentët mbi organizimin e syllabuseve lëndore, modulet përkatëse, detyrimet nga fillimi deri në fund, deri në mënyrën e testimit, vlerësimit të njohurive, etj. Titullarët e lëndëve i informojnë studentët në auditor ose përmes postës elektronike, ku dërgohen syllabuset ose materiale të tjera që mbështesin procesin mësimor.			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale bëhet me vlerësimin vazhduar (deri në 30%) dhe provim përfundimtar (deri 70%). Vlerësimi i vazhduar merr parasysh frekuentimin, angazhimin në laboratore, ushtrime, seminare, vlerësime të detyrave, projektkurseve etj. Provimi mund të realizohet me shkrim, me gojë, ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale bëhet me vlerësimin vazhduar (deri në 30%) dhe provim përfundimtar (deri 70%). Vlerësimi i vazhduar merr parasysh frekuentimin, angazhimin në laboratore, ushtrime, seminare, vlerësime të detyrave, projektkurseve etj. Provimi mund të realizohet me shkrim, me gojë, ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Nga RVB dhe Syllabuset lëndore konstatojmë se testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale ndahet në vlerësimin vazhduar (deri në 30%) dhe provim përfundimtar (deri 70%). Vlerësimi i vazhduar merr parasysh frekuentimin, angazhimin në laboratore, ushtrime, seminare, vlerësime të detyrave, projektkurseve etj. Provimi mund të realizohet me shkrim, me gojë, ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Minimumi për të qenë kalues është mbi 40% të gjithë pikëve.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në RVB dhe nga takimet konstatojmë se në UNIKO ende nuk është vënë në zbatim sistemi elektronik i testimit dhe vlerësimit të studentëve.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi	Në rastin e provimeve përfundimtare të secilës lëndë DA ngre

Handwritten signature

<p>përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>komisione me të paktën 2 pedagogë, njëri prej të cilëve është titullari i lëndës; për Provimin e diplomës komisioni përbëhet nga 5 anëtarë. Komisionet miratohen nga Dekani, përpara publikimit të datave të provimeve dhe të diplomës. Vlerësimi final i studentit llogaritet nga mesatarja e thjeshtë arithmetike e vlerësimeve të secilit pedagog anëtar i komisionit dhe procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Në RVB dhe nga takimet konstatuam se testimi i njohurive, dijeve me shkrim, nuk zhvillohej në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim; por ky proces administrohet përmes ESSE3 që garanton anonimatin dhe transparencën, për të cilën folëm edhe në Standardin III.3, Kriteret 8-9. Por kjo nuk ka të bëjë me testimin anonim të njohurive. Titullari i lëndës është përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, studentët kanë të drejtë të shikojnë tezën e provimit në prani të titullarit të lëndës, për sqarimet e duhura. Pasi pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve, printohet proces-verbali nga sistemi, firmoset nga titullari dhe dorëzohet në Sekretarinë Mësimore.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në RVB dhe nga anketimet me personelin akademik konstatohet se DA dhe personeli akademik i Programit zbatojnë rregullat dhe marrin masa për shmangien e mashtrimit akademik (kopjimit në provime, detyra) dhe plagjiaturës, të përcaktuara në Rregulloren e UNIKO, të DA, dhe të Programit si dhe në Syllabuset lëndore. Studentët, kanë për detyrë të respektojnë dispozitat e Kodit të Etikës¹⁰⁴ të UNIKO, për aq kohë sa gëzojnë statusin e studentit në universitet, përfshirë këtu edhe dispozitat që parashikojnë sjelljen e tyre.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në RVB dhe nga anketimet me personelin akademik konstatohet se DA dhe personeli akademik i Programit zbatojnë rregullat dhe marrin masa për shmangien e mashtrimit akademik (kopjimit në provime, detyra) dhe plagjiaturës, të përcaktuara në Rregulloren e UNIKO, të DA, dhe të Programit si dhe në Syllabuset lëndore. Studentët, kanë për detyrë të respektojnë dispozitat e Kodit të Etikës¹⁰⁴ të UNIKO, për aq kohë sa gëzojnë statusin e studentit në universitet, përfshirë këtu edhe dispozitat që parashikojnë sjelljen e tyre.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Gjithë rregullat e Programi u garantojnë studentëve të drejtën për kontrollin e dijeve dhe aftësive profesionale, dhe vlerësimin e tyre mbështetur tek merita. Testet e provimit ndërtohen mbështetur në materialin e trajtuar në leksione, seminare, laboratore dhe/ose praktika mësimore në terren. Çdo test ka të përcaktuar qartë pikët për secilën pyetje, që synon kontrollin e dijeve dhe aftësive, vlerësimin që merr studenti për atë pyetje dhe vlerësimin e përgjithshëm. Rezultatet jepen në kohë sipas përcaktimeve në dokumentacionet e mësipërme. Çdo titullar lënde hedh rezultatet e vlerësimit për çdo student përmes llogarisë personale në ESSE3, jo më vonë se 48 orë nga data e zhvillimit të tij¹⁰⁵.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për</p>	<p>Konstatohet se në DA, bazuar në dokumentacionet e mësipërme, garantohen edhe të drejtat e studentëve për t'u njohur me</p>

¹⁰⁴ + SHTOJCA 1.20 KODI I ETIKËS SË UNIKO.pdf


¹⁰⁵ SHTOJCA 1.6 RREGULLORE E ESSE 3.PDF; SHTOJCA 2.2 RREGULLORE E NJËSISË KRYESORE FAKULTETI I BUJQËSISË.PDF; SHTOJCA 2.3 RREGULLORE E NJËSISË BAZË AGRONOMI.PDF; SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL" NË "INXHINIERI AGRARE, PROFILI HORTIKULTURË" 2020-2023..pdf; SHTOJCA 4.15 MANUALI I PËRDORIMIT TË FAQES ZYRTARE WEB UNIKO .PDF

Alia Kalo

<p>rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht tezën e provimit, në prani të titullarit të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura. Nëse është e nevojshme jepen edhe këshilla për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Pasi pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve, printohet proces-verbali nga sistemi, firmoset nga titullari dhe dorëzohet në Sekretarinë mësimore¹⁰⁶.</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në qoftë se studenti nuk është dakord me vlerësimin e bërë ai ka të drejtë të bëjë ankimim te Dekani brenda 24 orëve pas shpalljes së rezultatit. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e në bashkëpunim me përgjegjësin e DA, vendosin që studenti të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit, ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës. Sekretaria e Dekanit regjistron në regjistrë ankesat e studentëve, si dhe vendimin që ka marrë dekani i Fakultetit për zgjidhjen e problemit. Në RVB dhe nga takimet në Institucion nuk dokumentohet të ketë patur ankesa të tilla në Programin në shqyrtim.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.7</p>	
<p>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Në RVB theksohet, por dhe ne kemi bindjen se Programi ofron njohuri të qëndrueshme e bashkëkohore në shkencat teorike bazë, formim të gjerë dhe njohuri të thelluara në fushën e hortikulturës. Programi mundëson formim të plotë të aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve të agronomisë. Organizimi Programit është organizuar përgjithësisht sipas veprimtarive formuese është në përputhje me VKM 41/2018: Megjithatë, sërish këtu RVB rithekson komentet e bëra lidhur me Planin Mësimor në Standardin II.1.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Në RVB theksohet se aftësitë në komunikim dhe IT, përfshirë edhe në gjuhë të huaj, studentët i demonstrojnë në përgatitjen dhe prezantimin e detyrave të kursit, gjatë zhvillimit të moduleve me karakter profesional. Kjo nuk dokumentohet qartë nga materialet në dosje, por nga takimet me personelin dhe me studentët, përfshirë edhe kushtet e pandemisë në dy vitet e fundit, ne mendojmë se kjo</p>

¹⁰⁶ Idem si më sipër



	kërkesë është relativisht e përmbushur.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	GVJ konstaton se ecuria e procesit mësimor për secilën lëndë/modul shqyrtohet edhe gjatë diskutimeve dhe në analizat vjetore të punës në DA, FB, NJSBC etj. Në Standardin III.1, Kriteri 2 kemi dhënë mendimet tona dhe këshillimet përkatëse lidhur më këto Raporte dhe analizën në fund. Në Dosje është edhe një model analize i zhvillimit të një moduli në fund (Shtojca 3.17). Këtu jepet rezultati vetëm për zhvillimin e një Moduli. Por nuk konstatohen të dhëna të tjera mbi këtë lloj analize, apo mbi pyetësorin e studentit, dhe ndonjë lloj diskutimi mbi këto të dhëna.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Gjithashtu, gjatë zhvillimit të lëndës, përpara provimit të çdo lënde/moduli (përpara provimit final), personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre. Për këtë, secili titullar lënde organizon konsultime me studentët përpara provimit përfundimtar, të parashikuara në syllabus. Kjo nuk dokumentohet qartë nga materialet në dosje (Programet Lëndore) ¹⁰⁷ , por nga takimet me personelin dhe sidomos me studentët, GVJ mendon se kjo kërkesë është relativisht e përmbushur.
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Në RVB dhe nga takimet në DA konstatohet për leksione të hapura ¹⁰⁸ , ku jepen njohuri mbi arritjet e personaliteteve të shquara, të vendit dhe të huaj, por edhe shembuj të veçantë të kompanive e fermerëve që kanë histori suksesi, si dhe perspektivave të zhvillimit të bujqësisë duke përfshirë sistemet moderne të kultivimit të pemëve frutore, vreshtarisë, perimeve, luleve etj.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Programi është i ndërtuar mbi bazë kompetencash, nëpërmjet zhvillimit të leksioneve, seminareve, laboratorëve dhe praktikave në terren. Ritheksojmë se shumë lëndë kanë laboratore dhe dhe praktika në terren, si Eksperimentimi në Bujqësi, Ekstensioni Bujqësor, Resurset Gjenetike të Drufrutorëve, Bimët Aromatiko-Mjekësore, Mjediset e Mbrojtura, Pemëtaria etj. ¹⁰⁹ Këto mundësojnë krijimin e aftësive profesionale nëpërmjet përdorimit të instrumentave laboratorike dhe punës në terren. Gjithashtu, detyrat dhe projektet e kursit sigurojnë thellimin e njohurive, zhvillojnë aftësitë profesionale, si të menduarit kritik, të mësuarit e bazuar në problem, komunikimin etj.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Nga RVB dhe intervistat konstatohet se personeli akademik i DA mbështet, krijon kushtet dhe nxit diskutimet dhe punën në grup. Këto nxisin zhvillimin e aftësive krijuese të studentëve, duke paraqitur e shpjeguar edhe problemet e ndryshme me të cilat

¹⁰⁷ SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL" NË "INXHINIERI AGRARE, PROFILI HORTIKULTURË" 2020-2023..pdf

¹⁰⁸ SHTOJCA 3.18 SHEMBULL I ORËVE TË HAPURA.PDF

¹⁰⁹ SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL" NË "INXHINIERI AGRARE, PROFILI HORTIKULTURË" 2020-2023..pdf

<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>përballet prodhimi bujqësor.</p> <p>Njohuritë e leksioneve konkretizohen në laborator, nëpërmjet ushtrimeve dhe punëve të thjeshta eksperimentale dhe praktikave mësimore dhe profesionale. Praktikrat profesionale kryhen nën kontrollin e pedagogut përgjegjës dhe drejtuesve të subjekteve të ndryshme të prodhimit apo përfaqësuesve të pushtetit vendor, dhe institucioneve me të cilat UNIKO ka marrëveshje bashkëpunimi. Në përfundim të praktikës profesionale studentët prezantojnë çfarë kanë parë dhe mësuar, si dhe çfarë ata propozojnë për të përmirësuar diçka, për situata të veçanta me të cilët ata janë ndeshur gjatë kohës së praktikës.</p>			
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>UNIKO mbështet dhe promovon idetë dhe praktikrat inovatore në bujqësi, duke nxitur zbatimin e praktikave të mira në çdo sektor të prodhimit bujqësor. Këto trajtohen gjatë leksioneve, në tekstet mësimore dhe dispensave. RVB pohon se materialet shkencore për studime të avancuara kërkimore e shkencore në UNIKO janë të kufizuara. Për këtë, personeli akademik ka përfshirë studentët, në projektet e kërkimit shkencor që financohen nga donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit¹¹⁰. Përfshirja e tyre në projekte u jep mundësi për t'u njohur me informacione dhe praktika që mund t'u shërbejnë për të ardhmen e tyre profesionale.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>UNIKO dhe FB kanë nënshkruar marrëveshje me kompani të ndryshme prodhimi, nëpërmjet të cilave mundësohen vizita dhe praktika afatshkurtra profesionale të studentëve në njësi të ndryshme prodhimi. UNIKO është partner në disa projekte të Bashkimit Evropian si dhe pjesëmarrës në programin ERASMUS+ (Shtojca 4.9). Këto projekte kanë bërë të mundur që disa studentë të ndjekin një pjesë të studimeve të tyre në Universitetet e tjera partnere. Në RVB pohohet se 2 studentë të Programit kanë qenë përfitues të drejtpërdrejtë të këtyre projekteve¹¹¹.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

¹¹⁰ SHTOJCA 4.9 MOBILITETE STAF STUDENT.PDF; SHTOJCA 4.8 TABELA E TË DHËNAVE PËR KUALIFIKIMIN DHE KËRKIMIN SHKENCOR.pdf


¹¹¹ SHTOJCA 4.9 MOBILITETE STAF STUDENT.PDF; SHTOJCA 4.8 TABELA E TË DHËNAVE PËR KUALIFIKIMIN DHE KËRKIMIN SHKENCOR.pdf

Standardi III.8**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Në RVB dhe nga takimet konstatojmë se DA bashkëpunon me Ekonominë Didaktike Eksperimentale (EDE) ¹¹² me sipërfaqe prej 19 ha, direkt nën varësi të UNIKO, me bazën e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), Korçë, dhe me sipërmarrje të ndryshme me drejtim bujqësor ¹¹³ . UNIKO ka marrëveshje bashkëpunimi me Qarkun Korçë, Bashkitë e Korçës, Pogradecit, Devollit, Ersekës dhe Maliqit dhe me institucione të tjera shtetërore (Shtojca 2.10) ¹¹⁴ . Mbështetur në këto marrëveshje studentë të Programit kryejnë praktika mësimore dhe profesionale pranë tyre. DA ka bashkëpunime edhe me një sërë biznesesh të tjera në fushën e prodhimit të kulturave të ndryshme bujqësore ku zhvillohen pjesa më e madhe e praktikave mësimore dhe profesionale. Këto janë të listuara në Shtojcën 3.5 ¹¹⁵ dhe në Udhëzuesin për Praktikën Profesionale (Shtojca 3.21) ¹¹⁶ .			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Lidhur me Praktikën Profesionale GVJ sërish rithekson: Praktika Profesionale është e vetmja Lëndë Plotësuese (D) me gjithsej 2 Kredite (3%). Sipas VKM 41/2017 në Masterin Profesional Lëndët Plotësuese (D) duhet të kenë një vëllim prej 10% (6 kredite). Këshillojmë që Praktika Profesionale të shkojë në 6 Kredite, 150 orë ose 6 javë punë në subjektet e kontraktuara. Më shumë lidhur me komente mbi përmirësimin e Planit Mësimor flitet në Standardin II.1			
Kriteri 3. Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niv. përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.9**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në RVB në Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të FB dhe atë të Programit është përcaktuar qartë procedura për dhënien e Provimit final ose Mbrojtjen e diplomës (Shtojca 3.11).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion	Lidhur me Provimin/Mbrojtjen e Diplomës GVJ sërish risjell komentet e dhëna në Standardin II.1 mbi përmirësimin e Planit

¹¹² + SHTOJCA 1.8 RREGULLORE E DREJTORISË FINANCIARE (EDE).PDF¹¹³ +RVB INXHINIERI AGRARE.PROFILI HORTIKULTURE LINK.pdf¹¹⁴ SHTOJCA 2.10 MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NË MBËSHTETJE TË PRAKTIKAVE PROFESIONALE.pdf¹¹⁵ SHTOJCA 3.5 TABELA E INSTITUCIONEVE BASHKËPUNUESE PËR PRAKTIKAT.pdf¹¹⁶ SHTOJCA 3.21 UDHËZUES PËR PRAKTIKAT PROFESIONALE.pdf


informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Mësimor:
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	-Programi mbyllet me veprimtarinë ‘Tezë diplome/Provimi diplome’, me 8 kredite, e llogaritur me 200 orë (ose 8 javë punë individuale e studentit). Puna e diplomës bëhet vetëm nga kandidatë të zgjedhur me mesatare note gjatë 3 viteve të para bachelor, kurse studentët e tjerë i nënshtrohen ‘Provimit’. Kjo nga sa kuptuam edhe nga takimet në DA dhe me studentët zhvillohet në pak javë, jo në 8 javë punë individuale e studentit, sa parashikohet në Plan (200 orë). Për më tepër, nuk del shumë qartë në dokumentacion mënyra si zhvillohet Provimi as në Rregulloren e Programit dhe as në Programet lëndore. Nuk del e qartë në Rregullore nëse Puna e Diplomës është Punë Eksperimentale, apo Punë Teorike, në Kabinet ose Bibliotekë.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	GVJ lidhur me Punën e Diplomës këshillon që secili student të ketë mundësinë e një pune eksperimentale konkrete , me 8 kredite, e llogaritur me 200 orë (ose 8 javë punë individuale e studentit), në udhëheqjen e një pedagogu dhe në bashkëpunim me subjektet bujqësore të zonës; kjo duhet të jetë në përparsi, ndaj punëve të diplomës me karakter teorik. Mendojmë se Provimi përfundimtar duhet të shmanget si i tillë dhe të zëvendësohet vetëm me Mbrojtje Diplome nga secili student, e cila është në frymën e kërkesave të Bolonjës, sidomos lidhur me kërkesat e një Masteri Profesional. Veprimtaria ‘Tezë diplome/Provimi diplome’ në Planin Mësimor të jetë vetëm veprimtarinë ‘Tezë diplome’.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në rastin e diplomimit me Punë diplome, studenti së bashku me pedagogun udhëheqës përcaktojnë planin e detajuar të punës, bazuar në fushën e studimit të përcaktuar, ku përfshihen, zona e studimit/objekti i studimit dhe baza materiale etj. Disa punë diplomash realizohen edhe me mbështetjen e institucioneve me të cilat DA ka marrëveshje.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Për diplomën studentin orientohet nga pedagogu udhëheqës për planin e punës dhe ndihmohet prej tij për kërkimin teorik, punën praktike, përpunimin e të dhënave etj. Në çdo hap studentin komunikon në mënyrë të vazhdueshme me udhëheqësin, duke ndjekur të gjitha hapat për punën dhe shkrimin e punimit duke zbatuar Udhëzuesin për punën e diplomës. Udhëheqësi garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit ¹¹⁷ .
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.	Mbrojtja e punës së diplomës bëhet para Komisionit së paku nga 5 anëtarë me tituj e grada shkencore, që mbulojnë disiplina të Programit, studentin vlerësohet me notë, bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e diplomimit. Komisioni i Punës së diplomës analizon punën paraprakisht; mbrojtja bëhet e


¹¹⁷ SHTOJCA 3.28 PËRFSHIRJA E STUDENTËVE NË PUNË SHKENCORE.pdf ; SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT “MASTER PROFESIONAL” NË “INXHINIERI AGRARE, PROFILI HORTIKULTURË” 2020-2023..pdf



	hapur, me prezantim të punimit, pyetje dhe përgjigje, dhe vlerësim me notë, e dokumentuar në procesverbalin përkatës, të dokumentuara te procedura e diplomimit ¹¹⁸ .			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të Programit, studenti pajiset me Diplomën “Master Profesional” në: “Inxhinieri Agrare, Profili Hortikulturë” (Shtojca 2.6), e cila regjistrohet në Regjistrin shtetëror të diplomave (Shtojca3.23). Diploma shoqërohet me suplementin e diplomës (Shtojca 3.20), e shkruar në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe. UNIKO dokumenton tërheqjen e diplomës dhe suplementit të diplomës prej secilit student që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike dhe ato të tjera institucionale.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Sekretaria mësimore e FB mban Regjistër themeltar, të arritjeve akademike, të lëshimit të diplomave të studentëve me të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së Programit të studimit, të dhëna mbi Diplomën ose diplomat e marra bashkë me Suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas standardeve shtetërore. Regjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe mbahet në ruajtje të përhershme. Përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve bëhet prej Sekretarisë mësimore në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri. Një kopje e punimeve të diplomave ruhen në fondin e DB në mënyrë të përhershme.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen	GVJ mendon se kushtet e punës dhe ngarkesa e Sekretares Mësimore në FB nuk ndihmojnë përpunim të saktë të informacionit gjatë procesit mësimor. Nga intervistat me Sekretarinë mësimore GVJ konstaton se nuk ka të dokumentuara auditime të brendshme të saktësisë së përputhjes së informacionit të vlerësimeve nëpërmjet procesverbaleve të personelit akademik me ato të Regjistrin themeltar dhe sistemit elektronik ESSE3. Këshillojmë që Institucioni të sanksionojë në Rregulloret përkatëse mënyrën e sigurisë/saktësisë së ruajtjes së sistemit të vlerësimit (notave), dhe parandalimin e gabimeve qoftë edhe njerëzore, dhe promovimin për auditimet me saktësi të lartë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹¹⁸ Idem si më sipër



IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga vëzhgimet dhe intervistat me personat përgjegjës, GVJ konstaton se të dhënat e personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ përditësohen çdo vit akademik nga përgjegjësi i departamentit të agronomisë, dhe nga zyra e burimeve njerëzore. UNIKO ka hartuar një Udhëzues specifik për përmbajtjen e dosjes së personelit akademik dhe të atij ndihmës (Shtojca 1.14)¹¹⁹, dhe nga GVJ konstatohet se Dosjet e personelit në Zyren e Burimeve Njerëzore, ishin të kompletuara dhe të përditësuara sipas këtij udhëzimi. Veç kësaj, rezulton se UNIKO zbaton në mënyrë të përpiktë ruajtjen e të dhënave personale në përputhje me “Ligjin për ruajtjen e të dhënave personale” përmes një rregulloreje të posaçme (Shtojca 1.9)¹²⁰.</p> <p>Pas takimit me personelit akademik dhe përgjegjës të DA, GVJ konstaton se të dhënat e reja rifreskohen në mënyrë periodike dhe ju dërgohen instancave përkatëse në FB dhe në UNIKO. Nga personeli akademik pohohet se këto të dhëna përditësohen edhe në faqen zyrtare të internetit të UNIKO, por fatkeqësisht GVJ konstaton se prej disa kohësh kjo faqe nuk është funksionale.</p> <p>GVJ konstaton se të dhënat mbi personelin akademik të FB, dhe të atij të angazhuar në Program, janë të plota (Shtojca 4.12 dhe Shtojca 4.1)¹²¹. Gjithashtu, konstatohet se edhe të dhënat mbi angazhimin e personelit akademik në Program dhe angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik janë të plota (Shtojcat 4.14 dhe 4.2)¹²².</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të Dosjes, GVJ konstaton se Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi (Ligji 80/2015) dhe aktet e brendshme rregullatore të Institucionit (Shtojca 1.13)¹²³.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të</p>	<p>GVJ konstaton se në UNIKO ndiqet procedura e shpalljes publike të vendit të punës në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe zyra e</p>

¹¹⁹ Shtojca 1.14: Udhëzimi për Përmbajtjen e Dosjes së Stafit

¹²⁰ Shtojca 1.9: Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale

¹²¹ Shtojca 4.12: Stafit akademik i Fakultetit të Bujqësisë; Shtojca 4.1: Tabela e Personelit Akademik të angazhuar në programin e studimit

¹²² Shtojca 4.14: Ngarkesa e plotë mësimore e stafit të departamentit të agronomisë; Shtojca 4.2: Tabela e ngarkesës së stafit akademik të angazhuar në të gjitha programet e studimit

¹²³ Shtojca 1.13: Udhëzimi për rekrutimin e stafit akademik

Alia Vaso

<p>posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>burimeve njerëzore pohon se kjo shpallje bëhet edhe faqen e Institucionit, por që kjo e fundit prej kohësh nuk është funksional.</p> <p>Nga intervistat e realizuara dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se procedura e rekrutimit të personelit akademik administrohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të UNIKO (Shtojca 1.4)¹²⁴.</p>			
<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Vetë DA përcakton kriteret për rekrutimet e reja në varësi të nevojës momentale dhe në përputhje me udhëzimin për rekrutimin.</p> <p>GVJ gjithashtu konstaton se Institucioni zbaton Ligjin e Arsimit të Lartë për rekrutimin e punonjësve akademikë, ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike (Shtojca 1.13)¹²⁵.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Pas vizitave të mjedisve dhe vlerësimit të infrastrukturës, vihet re se institucioni punon vazhdimisht për ofrimin e kushteve dhe mjedisve të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë sa më të mirë. Për realizimin e detyrave të tij, personeli akademik dhe ai ndihmës, shfrytëzon sallat e leksioneve, laboratorët, Ekonominë Didaktike Eksperimentale (EDE), mjediset e bibliotekës etj. (Shtojca 4.7)¹²⁶.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli është i përfshirë në projekte dhe veprimtari të ndryshme shkencore gjë që evidentohet nga niveli i lartë i kualifikimeve të personelit dhe veprimtaria shkencore, dhe nga dokumenta të tjera plotësuese që evidentojnë kërkimin shkencor dhe përvojën e tyre në këto disiplina. Vlen për t'u theksuar numri i mobiliteteve dhe trainimeve të personelit akademik jashtë vendit,</p>

¹²⁴ Shtojca 1.4: Rregullorja e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit

¹²⁵ Shtojca 1.13: Udhëzimi për rekrutimin e stafit akademik

¹²⁶ Shtojca 4.7: Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit të studimit



	<p>realizuar kjo falë projekteve të fituara nga Institucioni (Shtojcat 2.14, 2.15 4.8 dhe 4.9)¹²⁷.</p> <p>Pavarësisht kësaj, GVJ konstaton se institucioni nuk mbështet financiarisht ndonjë pjesëmarrje në konferenca/simpoziume jashtë vendit, apo publikim shkencor ndërkombëtar. Kjo gjë pohohet edhe nga vetë intervistat me personelin.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Pas shqyrtimit të Dosjes, GVJ konstaton se UNIKO ka mundur të realizojë trainime të vazhdueshme të personelit për metoda alternative të mësimdhënies (Shtojca 3.16)¹²⁸, e detyruar dhe nga kushtet e mësimdhënies <i>online</i> për shkak të pandemisë COVID-19. Studentët e programit të studimit, pohojnë se personeli akademik ka qenë mjaft efektiv në përvetësimin e këtyre metodave inovative.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga takimi me personelin akademik, GVJ konstaton se veprimtaria mësimore në këtë Program realizohet i plotë përmes angazhimit të personelit akademik efektiv (v.a. 2020-2021 dhe në vazhdim)¹²⁹. Personeli akademik që angazhohet në veprimtarinë mësimore dhe shkencore është pjesë e ekipit që ka hartuar Programin mësimor. Bashkangjitur janë: të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të personelit akademik, në të gjitha Programet e studimit dhe Ngarkesa e personelit akademik në këtë Program (Shtojcat 4.1 & 4.2)¹³⁰.</p> <p>RVG rithekson komentet e dhëna në Standardin II.2 lidhur me ngarkesën e personelit, të numrit të lëndëve, dhe përmirësime në strukturën moshore të personelit, vlerësimin e cilësisë së personelit dhe motivimin e më të mirëve, si dhe mbi qasjen pozitive dhe përpjekjet e vazhdueshme për të mundur pranime sa më cilësore në vitin e parë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

¹²⁷ Shtojca 2.14: Kualifikimet e stafit akademik; Shtojca 2.15: Veprimtaria shkencore e stafit akademik; Shtojca 4.8: Tabela e të dhënave për kualifikimin dhe kërkimin shkencor; Shtojca 4.9: Mobilitete staf student

¹²⁸ Shtojca 3.16: Model mësimi online

¹²⁹ SHTOJCA 4.14 NGARKESA E PLOTË MËSIMORE E STAFIT TË DEPARTAMENTIT TË AGRONOMISË

¹³⁰ Shtojca 4.1: Tabela e Personelit Akademik të angazhuar në programin e studimit; Shtojca 4.2: Tabela e ngarkesës së stafit akademik të angazhuar në të gjitha programet e studimit

<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Pas vizitës së mjediseve për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, GVJ konstaton se UNIKO, për realizimin e procesit mësimor ka vënë në dispozicion të gjitha mjediset e Institucionit. Në fillim të çdo semestri hartohet orari mësimor në të cilin detajohen mjediset mësimore se ku do të zhvillohen konkretisht leksionet, praktikat laboratorike, seminaret, etj. Nga shqyrtimi i Dosjes, rezulton se raporti i MASR për vlerësimin e kapaciteteve thekson se UNIKO i përmbush standardet sipas kërkesave të akteve ligjore në fuqi (Shtojca 1.15)¹³¹.</p> <p>Por shumë nga këto mjedisë janë të përbashkëta edhe për programe të tjera studimi dhe në disa raste nuk kuptohet qartë ngarkesa e secilës hapësirë në raport me numrin e Programeve të studimit për të cilat ajo përdoret.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedisë të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Pas vizitës së klasave, laboratorëve dhe mjediseve të tjera GVJ konstaton se shumica e mjediseve mësimore në FB, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Jo vetëm sallat e leksioneve, por edhe çdo laborator është i pajisur me videoprojektor, dërrasë të bardhë (<i>whiteboard</i>) dhe me numër të madh kompjuterash.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ pas vizitës së laboratorëve dhe mjediseve tjera konstaton se, UNIKO dhe FB në veçanti, zotërojnë disa laboratorë didaktikë dhe shkencorë që mundësojnë aftësim të studentëve në drejtim të shprehive praktike brenda mjediseve të universitetit.</p> <p>Konstatohet se një pjesë e aparatrave shkencore, janë të reja, por të papërdorura. Nga intervistat me personelin akademik ata pohojnë se këta laboratorë janë të mirëpajisur me aparatura laboratorike moderne, por vërehet vështirësi të vënies në funksion të tyre për shkak të mungesës së personelit teknik ndihmës dhe të aftësuar me këto metodologji shkencore, si dhe të mirëmbajtjes teknike të tyre.</p> <p>GVJ sugjeron se institucioni duhet të rrisë përpjekjet e tij për punësimin e personelit ndihmës teknik dhe trainimin e tij në mënyrë që të përvetësohen aftësitë teknike për të punuar me pajisje të tilla.</p> <p>Gjithashtu, ky Fakultet zotëron Ekonominë Didaktike Eksperimentale (EDE) me sipërfaqe prej 19 Ha, që konsiderohet laborator fushor i saj, ku në mënyrë të vazhdueshme studentët zhvillojnë aftësimin e tyre praktik dhe ku eksperimentohen metodologji të ndryshme¹³².</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë</p>	<p>Nga intervistat e drejtpërdrejta, konstatohet se këto laboratore apo mjedisë të tilla janë në dispozicion të të gjitha fakulteteve të UNIKO.</p>

¹³¹ Shtojca 1.15: Raport i kontrollit të MASR për kapacitetet pritëse të UNIKO

¹³² + SHTOJCA 1.8 RREGULLORE E DREJTORISË FINANCIARE (EDE).PDF

së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Kësisoj, nuk dokumentohet qartë shkalla e përdorimit nga studentët e këtij Programi studimi.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të porsaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	<p>Nga dokumentet e shqyrtuara, GVJ konstaton se FB ka bashkëpunime me institucione shtetërore dhe subjekte private me të cilat ka nënshkruar marrëveshje të porsaçme, për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në nivel institucional, rezultojnë se UNIKO ka marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale me të paktën 15 subjekte shtetërore ose private (Shtojca 3.5)¹³³. Edhe vetë FB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi 3-vjeçare me 5 subjekte private, të cilët ofrojnë asistencë në realizimin e praktikave mësimore dhe profesionale. Nga dokumentacioni rezultojnë se ekzistojnë të paktën 9 marrëveshje të tjera me institucione shtetërore (QTTB Korçë, Bashkia Devoll, Këshilli i Qarkut Korçë, Bashkia Maliq etj.) në të cilat vërehet një frymë bashkëpunimi për përmirësimin e këtij Programi studimi dhe asistencë në zhvillimin e praktikave profesionale sipas rastit (Shtojca 2.10)¹³⁴. Evidentohet dhe cilësohet si mjaft efektive veçanërisht marrëveshja e bashkëpunimit me QTTB Korçë (Shtojca 3.6)¹³⁵.</p> <p>GVJ sugjeron se shtimi i të tilla marrëveshjeve me nënshkrim të dyanshëm janë domosdoshmëri për konsolidimin e bashkëpunimit dhe janë tregues serioziteti në këtë angazhim.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të porsaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në Institucion dhe informacioni në Dosje, GVJ konstatoi se Biblioteka Shkencore e UNIKO dhe ajo e FB, është në dispozicion të personelit akademik dhe të studentëve për të mbështetur kërkimin shkencor, mësimdhënien dhe të studiuarit e thelluar. Sallat e literaturës janë të organizuara me fonde të hapura, të ndara sipas degëve të shkencës. Biblioteka garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë edhe nga studentët e këtij

¹³³ Shtojca 3.5: tabela e institucioneve bashkëpunuese për praktik

¹³⁴ Shtojca: 2.10: marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale

¹³⁵ Shtojca 3.6: Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit

Albin V. Sato

	Programi.
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita dhe takimi me përgjegjësen e Bibliotekës, GVJ vlerëson se Institucioni është i pajisur me literaturë fizike: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Konstatohet se biblioteka e FB zotëron 1540 libra në gjuhën shqipe dhe 670 libra në gjuhë të huaj (në total 1479 tituj). Nga ky fond, 920 libra i përkasin fushës së Bujqësisë (Shtojca 4.10)¹³⁶.</p> <p>Nuk ka të dhëna në Dosje që dokumentojnë se si është cilësia e titujve të librave që lidhen me Programin (p.sh. viti), dhe sa shfrytëzohet fondi i Bibliotekës, dhe sa vende ulur ka Salla e leximit dhe shfrytëzohet nga personeli dhe studentët Programit. Kjo ka rëndësi për të parë se sa të efektshme kanë qënë hapësirat ekzistuese dhe blerjet, dhe cilat janë kërkesat për hapësira dhe për tituj librash.</p> <p>GVJ këshillon se gjithmonë ka vend për pasurim të Bibliotekës me botime të reja dhe specifike për mbulimin e të gjitha moduleve të veprimtarisë mësimore të Programit të studimit. (shih edhe komentet në Standardin III.3, Kriteret 5 & 6).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Biblioteka ka ofruar informacione dhe literaturë <i>online</i> nëpërmjet Bibliotekës Digjitale <i>ProQuest</i>, por tashmë ky shërbim nuk ofrohet më; e drejta e anëtarësimit në këtë Bibliotekë ishte deri në 28 shkurt 2019. Ndërrimi i këtij shërbimi u konfirmua edhe nga vetë Dekani i FB.</p> <p>Nga dekanati pretendohet se institucioni ka hartuar dhe zbaton një plan për shtimin e zërave të Bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të të gjitha programeve të studimit, por kjo gjë nuk dokumentohet qartë.</p> <p>Edhe këtu, mbështetur në intervistat tona me Bibliotekën dhe drejtuesit në Institucion, ka rëndësi edhe ndjekja nga DA (por jo vetëm) e shfrytëzimit të Bibliotekës <i>online</i>, e titujve të kërkuar, qoftë nga studentët, por edhe nga anëtarët e personelit. Kjo ka rëndësi për të parë se sa të efektshme kanë qënë përpjekjet për të siguruar aksesin <i>online</i>, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe performancën e personelit.</p> <p>GVJ këshillon se Institucioni duhet domosdoshmërisht të bëjë përpjekje maksimale për ofrimin e një shërbimi bibliotekar <i>online</i> me fond të pasuruar dhe bashkëkohor, pasi kjo lehtëson punën e studentëve dhe personelit akademik, veçanërisht në kushtet e pandemisë me të cilat jemi përballur.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë</p>	<p>Nga vizitat në Institucion, GVJ vlerëson se Biblioteka disponon një</p>

¹³⁶ Shtojca 4.10: Të dhëna për fondin e librave në bibliotekë në funksion të programit të studimit

e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	sallë moderne me 10 kompjutera, e cila është në shërbim të personelit akademik dhe studentëve të UNIKO. Kjo sallë është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike (libra, postera, harta, CD-ROM) dhe shërbim interneti.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Gjatë intervistave u pohua se çdo autor, libri i të cilit përdoret si tekst bazë apo alternativ në këtë program studimi duhet domosdoshmërisht të dorëzohet të paktën 3 kopje në Bibliotekë. Në realitet, kjo praktikë nuk është gjithmonë funksionale. GVJ sugjeron që institucioni të hartojë udhëzues dhe politika motivuese për personelin akademik në këtë drejtim.			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Konstatohet se Biblioteka ka hapësirat e nevojshme për t'i shërbyer të gjithë studentëve të këtij programi studimi dhe më gjerë. Ajo është e hapur në orarin 08.00 – 16.00 nga e hëna në të premte. Pas takimit me studentët GVJ konstaton se vërehet një indiferencë nga ana e tyre për frekuentimin e Bibliotekës. Ata pohojnë se të gjithë literaturën bazë dhe atë ndihmëse për çdo lëndë në planin mësimor, e marrin në formë elektronike ose të shtypur nga pedagogu përkatës. Për më tepër, GVJ sugjeron krijimin e një emaili zyrtar të Bibliotekës, në të cilin studentët mund të kërkojnë informacion për tituj librash apo për funksione të tjera që ofron biblioteka.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Pas takimit me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave, GVJ konstaton se UNIKO disponon sistem menaxhimi të informacionit të saj, ESSE3, nëpërmjet të cilit administron çdo gjë që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit si: hyrjen (regjistrimin e tyre në programe studimi) dhe lëvizjet (transferimet e tyre), faturimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave etj. Kjo konstatohet dhe nga marrëveshja e UNIKO me Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH) (Shtojcat 1.6 dhe 1.6.1) ¹³⁷ .
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin	GVJ konstaton se UNIKO disponon dhe e ka plotësisht funksional sistemin ESS3 në përputhje me marrëveshjen që ka me Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH) (Shtojca 1.6.1). Përveç informacionit të

¹³⁷ Shtojca 1.6: Manual i sistemit elektronik ESSE3; Shtojca 1.6.1: Marrëveshje RASH për ESSE3



<p>dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>mësipërm, në këtë sistem plotësohen dhe procesverbalet e provimit ku secili student shikon vlerësimin për çdo provim të dhënë në mënyrë individuale.</p> <p>Nga intervistat me Sekretarinë mësimore dhe përmbajtja e Dosjes, GVJ konstaton se nuk ka të dokumentuara auditime të brendshme të saktësisë së përputhjes së informacionit të vlerësimeve nëpërmjet Procesverbaleve të personelit akademik me ato të Regjistrin themeltar dhe Sistemit elektronik ESSE3. Këshillojmë që Institucioni të sanksionojë në Rregulloret përkatëse mënyrën e sigurisë/saktësisë së ruajtjes së sistemit të vlerësimit (notave), dhe parandalimin e gabimeve qoftë edhe njerëzore, dhe promovimin për auditimet me saktësi të lartë. GVJ e ka vërtetur këtë mangësi edhe në shqyrtime dosjes të tjera dhe këshillojmë ASCAL ta mbajë gjithashtu parasysht.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se sistemi i menaxhimit siguron akses vetëm për personelin akademik, atë ndihmës akademik dhe studentët, të cilët janë pajisur me kredencialet specifike të gjeneruara nga institucioni. Çdo individ i lartpërmendur, hyn në sistem nëpërmjet një <i>username</i> dhe fjalëkalimi specifik dhe unik. Për personelin dhe studentët, institucioni ka hartuar dhe ka vënë në dispozicion një udhëzues për përdorimin e sistemit elektronik ESSE3 (Shtojca 1.6). Nga intervistat me studentët dhe personelin, rezulton se ata janë mjaft të familjarizuar me përdorimin e këtij sistemi elektronik.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ vlerëson se sistemi i menaxhimit elektronik ESSE3 mundëson vendosjen e teksteve në word, krijimin e menuve sipas organizimit vetiak të çdo pedagogu, ngarkimi dhe shkarkimi i materialeve të ndryshme në word, power point, pdf, video etj. Për të gjitha këto aplikime, institucioni ka vënë në dispozicion të personelit dhe të studentëve një manual të përdorimit të tyre (Shtojca 3.24)¹³⁸. Studentët mund të shkarkojnë materialet e ngarkuara nga pedagogu, mund të bëjnë komente apo pyetje të ndryshme në to etj. Gjithsesi, nuk dokumentohet konkretisht masiviteti në përdorim i kësaj platforme nga studentët.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>GVJ konstaton se informacionet e ngarkuara në sistem nga personeli akademik në Sistemin ESSE3, si p.sh. pyetësorët, leksionet, vlerësimet gjatë vitit, vlerësimi përfundimtar etj. janë të dukshëm në kohë reale dhe të aksesueshme nga studentët dhe organet drejtuese dhe titullarët. Nga intervistat me studentët, ata pohojnë se janë mjaft të kënaqur dhe janë familjarizuar më së miri me funksionimin e këtij sistemi menaxhimi.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku</p>	<p>Grupi GVJ konstaton se këto dokumente nuk janë të dukshme në faqen zyrtare të UNIKO (https://www.unkorce.edu.al/). Nga takimi në Institucion kuptuam se kjo është pasojë e mosplotësimeve të detyrimeve që Institucioni ka me Rrjetin Akademik Shqiptar</p>

¹³⁸ Shtojca 3.24: Manual për mësimin online: Manual për përdorimin e Moodle

njëra prej tyre është gjuha shqipe	(RASH) (https://www.rash.al/sq/). Këshillojmë që të bëhen përpjekje që këto të zgjidhen dhe faqja e UNIKO të bëjë të mundur shikimin e këtyre dokumentave dhe dokumentave të tjera me karakter informues, sidomos ato që lidhen me programet e studimit, me planet mësimore, programet lëndore (Syllabuset) etj. Kjo do të ndihmonte në njohjen më mirë nga të interesuar për ndjekjen e këtyre programeve, përfshirë dhe Programin nën shqyrtim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstaton se UNIKO ka plotësisht efektive Drejtorinë Financiare dhe Drejtorinë ekonomike, të cilat funksionojnë mbi bazën e rregulloreve të posaçme (konkretisht, Shtojcat 1.7 & 1.8) ¹³⁹ . Këto struktura garantojnë mbështetjen financiare të programeve të studimit bazuar në rregulloren financiare të UNIKO (Shtojca 1.8.1) ¹⁴⁰ . Mbi bazën e kërkesave specifike të Programit të studimit dhe analizave vjetore, hartohet një raport financiar i kostove të Programit dhe Planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për të paktën një cikël të plotë studimi. Informacionet e nevojshme për hartimin e këtij raporti, UNIKO i merr nga njësitë bazë dhe ato kryesore (Shtojca 3.15) ¹⁴¹ .
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion	GVJ pas analizës së dokumenteve konstaton se nuk dokumentohet qartë buxheti për këtë program studimi . Plani i financimit të paraqitur (Shtojca 4.11) ¹⁴² , paraqet vlera përgjithësuese të financimit për të gjithë UNIKO, për një periudhë 4 vjeçare. Pra, është një tabelë e përgjithshme e buxhetit të planifikuar dhe të përdorur nga i gjithë UNIKO. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se nuk figurojnë shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve, pajisjeve laboratorike, kimikateve, reagentëve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për Bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat <i>online</i> . DA duhet të ndjekë dhe raportojë mbi realizimin e buxhetit të

¹³⁹ Shtojca 1.8: RRegullore e drejtorisë financiare; Shtojca 1.7: Rregullore e drejtorisë ekonomike

¹⁴⁰ Shtojca 1.8.1: Rregullorja financiare

¹⁴¹ Shtojca 3.15: praktika të miratimit të buxhetit të UNIKO

¹⁴² Shtojca 4.11: Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit

<p>të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>miratuar të vitit paraardhës, ku të evidentohen edhe vonesat, mungesat, shkeljet dhe shpërdorimet në zbatimin e planit të përvitshëm, dhe masat përkatëse.</p> <p>DA duhet të ndjekë dhe të raportojë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit <i>online</i> (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit <i>online</i> nga personeli dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij <i>online</i>, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni kryen auditim të përvitshëm të brendshëm, duke përgatitur një pasqyrë të qartë të situatës financiare për përdorimin e të ardhurave të grumbulluara nga shërbimet që ofron Institucioni në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë (Shtojca 4.11). Konstatohet se ky raport diskutohet dhe analizohet në detaje nga strukturat drejtuese, veçanërisht nga Bordi i Administrimit të UNIKO, i cili, veç të tjerash, ndër funksionet themelore të tij ka miratimin e buxhetit vjetor dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij (Shtojca 1.21)¹⁴³.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se UNIKO, në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, dokumenton raportet financiare për tre vitet e kaluara akademike (Shtojca 4.11). Kjo procedurë mbikëqyret nga Bordi i Administrimit (Shtojca 1.21). Gjithashtu, institucioni planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të Programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij, por edhe kjo nuk del qartë nga dokumentacioni në dosje.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>GVJ vlerëson se Institucioni përgjithësisht garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të Programit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. Bordi i administrimit është përgjegjës për garantimin e qëndrueshmërisë financiare të UNIKO. Megjithatë, kjo nuk ceket në informacionin që ka Dosja, dhe as në RVB, si ndodh rëndom edhe në në disa dosje të tjera që ne kemi shqyrtuar.</p> <p>GVJ mendon se aspekti financiar është shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e cilësisë dhe qëndrueshmërinë e çdo Programi. Konkretisht konstatohet:</p> <p>Nga të dhënat mbi të ardhurat dhe shpenzimet vjetore të UNIKO në Shtojcën 4.11¹⁴⁴, duket se UNIKO për vitin 2020 ka harxhuar gjithsej një shumë prej 436,040,130 lekë, për mësimdhënien dhe</p>

¹⁴³ Shtojca 1.21: Rregullore e bordit të administrimit

¹⁴⁴ SHTOJCA 4.11 TË DHËNA NGA PLANI I FINANCIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.pdf

	<p>gjithë veprimtaritë që lidhen me të (për rreth 4613 studentë për 2019-2020¹⁴⁵), ose rreth 94,500 lekë (rreth 770 Euro) për student. Këtu nga sa kuptohet nuk futen të ardhurat nga Projektet e ndryshme, aspekt ky që shpesh nuk merret në shqyrtim nga Raportimet financiare të IAL-ve ku ne punojmë ose kemi qenë për vlerësim!</p> <p>Edhe pse kjo vlerë tregon një farë përmirësimi krahasuar me pak vite më parë për IAL-të publike¹⁴⁶, përsëri mbetet shumë e ulët, ndoshta ndër më të ulëtat që ne kemi konstatuar nga vlerësimet në disa IAL publike, pa folur për sistemin e IAL-ve private në Shqipëri, dhe sidomos për sistemin universitar në rajon dhe më gjerë. Kjo ndikon edhe në nivelin e përgjithshëm të pagave të personelit akademik dhe atij ndihmës, mesterisht të ulëta në rajon, në motivimin e personelit, si dhe në cilësinë e mjediseve laboratorike, pajisjet, kimikatet, qelqurinat, parcelat eksperimentale, botimit të librave, të bibliotekës, kualifikimit shkencor etj. Ka shumë rëndësi të gjenden rrugët dhe mundësitë për të shëndoshur gjendjen financiare në UNIKO dhe më gjerë në IAL-të e tjera publike.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi	Konstatohet nga shqyrtimi i dokumentacionit, por dhe nga intervistat me Përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave se aplikohen politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik për këtë program studimi, të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi

¹⁴⁵ + SHTOJCA 1.15 RAPORTI I KONTROLLIT TË KAPACITETEVE TË MASR.PDF, f. 6

¹⁴⁶ Gjonçaj, 2015; f. 35; https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Raport_Final_Ministria_Arsimit.pdf

dhe aktet e veta rregullatore.	(Ligjit 80/2015). Këto politika dhe procedura janë shprehur mjaft qartë në dokumentacionin e UNIKO (Shtojcat 1.1 & 1.2) ¹⁴⁷ . Theksohet në Statutin e UNIKO (Kreu VI, neni 52) se “Pranimi në programet e ciklit të dytë është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e vendosura nga njësia bazë ku ata aplikojnë”. Kjo konstatohet edhe në rregulloren e Programit të studimit (Shtojca 2.5).
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga takimet me Drejtorinë e Kurrikulave dhe me studentët, rezultojnë se të gjithë studentët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe nuk vërehen raste të diskriminimit gjinor, racor, fetar etj. Nga shqyrtimi i Dosjes dhe në Rregulloren e studimeve të FB (Shtojcat 1.1 & 2.2) ¹⁴⁸ , në asnjë rast nuk vërehet ndonjë kriter diskriminues i studentëve apo trajtim i pabarabartë i tyre.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Konstatohet se kriteret e pranimit të kandidatëve në këtë Program dhe gjithë proceset e tjera deri në përfundim të studimeve janë përcaktuar në Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore të FB (Shtojca 2.2), në Rregulloren e DA dhe në Rregulloren e Programit (Shtojcat 2.3 & 2.5) ¹⁴⁹ . Nga shqyrtimi i Dosjes (Shtojca 3.9) ¹⁵⁰ rezultojnë se UNIKO shpall kriteret specifike në varësi të Programit të studimit. <i>Shih</i> komentet në Standardin IV.5, Kriteri 6, lidhur me shikueshmërinë e këtyre dokumenteve nga jashtë në faqen zyrtare të UNIKO (https://www.unkorce.edu.al/).
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Konstatohet qartë nga Shtojcat 2.3 dhe 2.5 se kriteret për përfshirjen në këtë program studimi janë të paraqitura në mënyrë të detajuar.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Rezultojnë se QKA ¹⁵¹ përgjegjëse për këtë Program studimi ka lidhje dhe mban kontakte të vazhdueshme me studentë të diplomuar që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë dhe që plotësojnë kriteret për t'u rregjistruar në këtë program studimi. Institucioni disponon një manual informimi, të cilin e shpërndan në formë elektronike ose të shtypur tek të gjitha palët e interesuara (Shtojca 3.11) ¹⁵² . Nga intervista me përfaqësuesit e QKA, konstatohet se ata kanë organizuar takime të drejtpërdrejta dhe/ose <i>online</i> të vazhdueshme

¹⁴⁷ Shtojca 1.1: Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli' dhe Shtojca 1.2: Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore e UNIKO

¹⁴⁸ Shtojca 1.1: Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'; Shtojca 2.2: Rregullore e njësive kryesore "Fakulteti i Bujqësisë"; Shtojca 1.1: Statuti i Universitetit 'Fan S. Noli'

¹⁴⁹ Shtojca 2.3: Rregullore e njësive bazë "Departamenti i Agronomisë"; Shtojca 2.5: Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional" në "Inxhinieri Agrare, Profili Hortikulturë"

¹⁵⁰ Shtojca 3.9: Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit

¹⁵¹ + SHTOJCA 1.5 RREGULLORE E DREJTORISË SË KURRIKULAVE (NJSBC, QKA).PDF

¹⁵² Shtojca 3.11: Praktika e informimit të studentëve me programin e studimit

	<p>me palë të interesuara për t'u rregjistruar në këtë program studimi. Edhe vetë DA e thekson informimin në shkallë të gjerë si domosdoshmëri për qëndrueshmërinë e këtij Programi (Shtojca 2.4)¹⁵³.</p> <p>Por, GVJ thekson sërish domosdoshmërinë e bërjes funksionale të faqes zyrtare të internetit të UNIKO, ku i gjithë informacioni të ishte lehtësisht i aksesueshëm për publikun e gjerë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët u konstatua se ishin kryer edhe takime informuese me studentët e ciklit të parë bachelor nga përgjegjësi i DA dhe personeli akademik, duke i informuar studentët mbi programet e studimit të ciklit të dytë dhe kriteret e pranimit në to. Studentët pohojnë se kanë qenë të mirëinformuar në lidhje me përmbajtjen e Programit, kohëzgjatjen e tij, rregulloren e Programit dhe çdo informacion tjetër të dobishëm në lidhje me këtë Program.</p> <p>Por GVJ sërish thekson se këto informacione duhet të jenë të aksesueshme nga publiku i gjerë nëpërmjet faqes zyrtare të UNIKO.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Konstatohet se Rregullorja e organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore të FB (Shtojca 2.2), Rregullorja e DA (Shtojca 2.3) dhe Rregullorja e Programit të studimit (Shtojca 2.5) përcaktojnë qartë kriteret dhe procedurat për transferimin në të njëjtin cikël studimi, ekuivalentimin e programeve që transferohen, regjistrimin pas pranimit të transferimit, transferimin e studentëve të UNIKO drejt institucioneve të tjera etj.</p> <p>Zyra e Sekretarisë Mësimore shërben për informimin e studentëve dhe për përgatitjen e dokumentacionit lidhur me regjistrimet, çregjistrimet, kërkesat për transferim etj. (Shtojca 1.10)¹⁵⁴. I gjithë ky proces ndiqet dhe monitorohet në mënyrë rigoroze nga Drejtoria e kurrikulave, sigurimit të cilësisë dhe kërkimit shkencor (Shtojca 1.5)¹⁵⁵.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon</p>	<p>GVJ konstaton se këto janë elementë që rezultojnë të paraqitura mjaft</p>

¹⁵³ Shtojca 2.4: Plani strategjik për zhvillimin e programit / njësisë

¹⁵⁴ Shtojca 1.10: Rregullore e sekretarisë mësimore UNIKO

¹⁵⁵ Shtojca 1.5: Rregullorja e Drejtorisë kurrikulave, sigurimit të cilësisë dhe kërkimit shkencor

<p>studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>qartë në Rregulloren e programit të studimit (Shtojca 2.5). Gjithashtu ky informacion gjendet edhe në Syllabuset e lëndëve (Shtojca 2.8)¹⁵⁶. Gjatë takimit me studentët dhe pedagogët u vu re se procesi është transparent dhe nuk u shprehën për probleme apo pakënaqësi lidhur me procesin.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se ky informacion është i detajuar dhe paraqitet në Rregulloret e FB (Shtojca 2.2), dhe të DA (Shtojca 2.3) si dhe në Rregulloren e Programit të studimit (Shtojca 2.5). Nga intervistat me personelin akademik dhe me studentët, ata pohojnë se këto rregullore janë të hostuara edhe në sistemin elektronik të brendshëm të UNIKO. Por për GVJ është e pamundur të evidentohet ky fakt pasi ai nuk është i aksesueshëm nga jashtë.</p> <p>Edhe për punimin e diplomës ka kriteret të përcaktuara për t'u punuar, dorëzuar dhe mbrojtur para Komisionit, dhe të gjitha këto informacione i komunikohen studentëve nëpërmjet personelit administrativ dhe atij akademik (Udhëheqësi i Diplomës). Këto kriteret janë të përcaktuara edhe në Rregulloren e programit të studimit (Shtojca 2.5) dhe studentët pohojnë se janë njohur që në fillim të studimeve mbi procedurën e përgatitjes së provimit të diplomës.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Konstatohet se Institucioni aplikon forma të ndryshme për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi Programin e studimit si: komunikime dhe kontakte të drejtpërdrejta, informim nëpërmjet sistemit elektronik të brendshëm (duke pasur parasysh që shumica prej të interesuarve janë studentë që kanë mbaruar ciklin e studimeve bachelor në këtë universitet) etj. Ky fakt evidentohet jo vetëm nga shqyrtimi i dokumentacionit (Shtojca 3.11)¹⁵⁷, por pohohet dhe nga intervista me personelin akademik dhe studentët e Programit.</p> <p>Por GVJ këshillon se më shumë duhet bërë në këtë aspekt si nga DA, ashtu dhe nga vetë Institucioni, në mënyrë që programe të tilla studimi me interes kombëtar të thithin studentë sa më cilësorë. Kjo duke filluar nga faja zyrtare e UNIKO deri te vendosja me përparësi nga MASR dhe UNIKO, e degëve të bujqësisë ndaj disa degëve të tjera, nga mbështetja me bursa studimi për kandidatë cilësorë (me mesatare të lartë) që vazhdojnë degët e bujqësisë, pse jo dhe motivimi më shumë i personelit etj. (shih Standardin IV.2, Kriteri 4).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

¹⁵⁶ Shtojca 2.8: Programet lëndore të programit të studimit

¹⁵⁷ Shtojca 3.11: Praktika e informimit të studentëve me programin e studimit



Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Nga intervistat me studentët u pohua se ata informohen që në fillim të studimeve në lidhje me shumë çështje që kanë lidhje me këtë program studimi. Nga intervistat ata pohojnë se Rregullorja e FB (Shtojca 2.2), Rregullorja e DA (Shtojca 2.3) dhe Rregullorja e Programit (Shtojca 2.5) janë publike në sistemin elektronik të brendshëm dhe në faqen zyrtare të internetit të UNIKO. Gjatë intervistave studentët theksojnë se ata informohen nga i gjithë personeli akademik i këtij Programi për detajet e tij dhe angazhimet e tyre në procesin mesimor.</p> <p>Por GVJ nuk i sheh dot në sistemin elektronik të brendshëm pasi nuk lejohet hyrja për përdorues të jashtëm. Gjithashtu, faqja zyrtare UNIKO, për momentin nuk është funksionale.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Nga intervistat me studentët u pohua se ata janë të informuar mbi përmbajtjen e lëndës, ndarjen në module, shpërndarjen e krediteve, personelin akademik përgjegjës për secilin modul, mënyrën e shlyerjes së lëndës etj. Ky është një Program studimi i shtrirë në 1 vit akademik dhe studentët pohojnë se ata kanë dijeni që në fillim të regjistrimit mbi përmbajtjen e Planit mesimor dhe zhvillimin e elementëve të Programit të lëndës. Gjatë inspektimeve në mjediset e në përdorim për këtë Program studimi në ndërtesën e FB, GVJ konstaton se Plani mesimor dhe detaje të tjera të lidhura me procesin mesimor, janë të afishuara nëpër stenda të posaçme</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>UNIKO ka krijuar Qendrën e Karrierës dhe Alumni, që funksionon nën varësinë e Drejtorisë së kurrikulave, sigurimit të cilësisë dhe kërkimit shkencor (Shtojca 1.5). Kreu III, neni 9 dhe neni 10 i kësaj Rregulloreje specifikojnë detyrat e QKA dhe të specialistit në zyrën e QKA në lidhje me mundësitë për punësim dhe orientimin drejt tregut të punës. Nga intervista me përfaqësues të QKA, pohohet se bëhet një punë intensive në drejtim të orientimit të studentëve drejt tregut të punës, orientim ky i bazuar në Studimin periodik të tregut të punës (Shtojca 3.12).</p> <p>Por, konstatohet dhe pohohet dhe nga punonjësit e QKA se pjesëmarrja e studentëve në këto aktivitete është e ulët.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mesimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në</p>	<p>Gjatë intervistave nga studentët u pohua se ato janë plotësisht të informuar nga institucioni në lidhje me këto çështje dhe asistohen për informim të vazhdueshëm. Nga inspektimi i mjediseve të DA, GVJ vuri re se informacioni mbi orarin dhe sallat ishte i afishuar në stenda; sallat janë të etiketuara me numra, të cilat përputhen me informacionin në orar.</p>



funksion të realizimit të tij.	Por GVJ sërisht thekson se ky informacion duhet të jetë publik dhe i aksesueshëm dhe nga jashtë, e cila ndodh nga mosfunksionimi i faqes zyrtare të internetit të UNIKO.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	Konstatohet se studentët disponojnë llogaritë e tyre elektronike, nëpërmjet të cilave mund të marrin të gjitha informacionet e duhura në portalin elektronik ESSE3. Nga studentët u pohua se ata përdorin me mjaft lehtësi dhe në mënyrë tepër komode këtë sistem elektronik. Nga aty, ata mund të shkarkojnë edhe informacione, leksione dhe materiale të ndryshme të ngarkuara nga personeli akademik. Për lehtësimin e procedurës së përdorimit të sistemit elektronik të brendshëm ESSE3, institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe të personelit akademik Manualin e sistemit elektronik ESSE3 (Shtojca 1.6).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Gjatë takimit me Zyrën e sekretarisë mësimore të Fakultetit të Bujqësisë, UNIKO, rezultoi se mbahen me korrektesë dhe përpikëri të plotë të gjitha statistikat e nevojshme për këtë Program studimi (Shtojcat 3.25 & 3.26) ¹⁵⁸ . Zyra funksionon me një rregullore të posaçme që garanton ruajtjen e të dhënave personale (Shtojca 1.9) ¹⁵⁹ .
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në zyrën e Sekretarisë mësimore, konstatohet se e gjithë puna për të përmbushur të gjithë këto elementë ishte e realizuar në mënyrë korrekte dhe të saktë. Përveç bazës së të dhënave në sistemin e brendshëm ESSE3, zyra e Sekretarisë mësimore disponon informacion të shkruar në regjistra të ndryshëm mbi regjistrimet dhe ecurinë e studentëve dhe mbi procedura të transferimit të tyre (Shtojcat 4.4 & 4.5) ¹⁶⁰ . Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në tre vitet e fundit për këtë Program studimi është si më poshtë: Për vitin akademik 2018 – 2019, 29 studentë; për v.a. 2019 – 2020, 28 studentë; për v.a. 2020 – 2021, 12

¹⁵⁸ Shtojca 3.25: Regjistrimi dhe diplomimi i studentëve; Shtojca 3.26: Regjistrimi i studentëve në hyrje

¹⁵⁹ Shtojca 1.9: Rregullore e ruajtjes së të dhënave

¹⁶⁰ Shtojca 4.4: Tabela e të dhënave të regjistrimit dhe ecurisë së studentëve në hyrje dhe dalje; Shtojca 4.5: Tabela e transferimeve të studentëve prej dhe nga programi i studimit

	studentë.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Konstatohet se edhe kjo çështje realizohej me korrektesë të lartë nga zyra e Sekretarisë mësimore. Të dhënat për ecurinë e studentëve administroheshin sipas rregullave të përcaktuara në rregulloret pwrkatwse (Shtojcat 1.2 & 1.10) ¹⁶¹ . Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitave në Sekretarinë mësimore rezultoi se Institucioni disponon dokumentacion të plotë periodik në lidhje me statistikën vjetore të studentëve të regjistruar (Shtojca 3.26) ¹⁶² . I gjithë informacioni i domosdoshëm mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të Programit dhe të gjitha statistikën vjetore ruhen në bazën e të dhënave të sistemit ESSE3 dhe në Raportin e analizës vjetore të DA (Shtojca 3.8) ¹⁶³ .
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe nga intervistat vihet re se edhe Sekretaria mësimore përdor sistemin ESSE3 për ruajtjen e të dhënave. Nga intervistat u pohua se kjo platformë rezultoi tepër efikase dhe e sigurtë në përdorim. Por GVJ sugjeron që domosdoshmërisht duhet të realizohet një auditim i brendshëm periodik për të garantuar efektivitetin e sistemit dhe për të shmangur ndonjë problematikë të sistemit ose ndonjë ndërhyrje të padëshiruar. Shih dhe komentet në Standardin III.9, Kriteri 10.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	GVJ konstaton se QKA përgatit raporte periodike të detajuara mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve (Shtojca 4.4) ¹⁶⁴ . Të cilat përgatiten në bashkëpunim me personelin akademik të njësive bazë dhe me të dhënat që gjenerohen nga Sekretaria mësimore. Veç kësaj konstatohet se Institucioni përgatit të dhëna përmbledhëse për punësimin e të diplomuarve të Programit të studimit (Shtojca 4.6). Por nga të dhënat e QKA (Shtojca 4.6), nga 16 të diplomuar në këtë Program, vetëm 3 kanë deklaruar në pyetësor, dhe vetëm 1 prej tyre është i punësuar. Shumica e të diplomuarve (13 të diplomuar) nuk i janë përgjigjur pyetësorit. Nga përfaqësues të QKA, u pohua se individët e diplomuar shfaqin indiferencë të plotësisht të këtij pyetësori dhe në shumë raste janë humbur kontaktet me ta për shkak të ndryshimit të numrave të telefonit apo adresave e-mail. Duket se kjo mënyrë e ndjekjes së punësimit dhe e vlerësimit të tregut të punës nuk funksionon sa duhet. GVJ këshillon të gjenden mënyra të kombinuara për të gjetur qoftë kërkesat reale të tregut të punës, qoftë bashkëpunimet me bizneset e sektorit të bujqësisë në Rajon, dhe më gjerë në Shqipëri, për cilësinë e të diplomuarve, për

¹⁶¹ Shtojca 1.2: Rregullorja e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore e UNIKO; Shtojca 1.10: Rregullore e sekretarisë mësimore e UNIKO

¹⁶² Shtojca 3.26: Rregjistrimi i studentëve në hyrje

¹⁶³ Shtojca 3.8: Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë

¹⁶⁴ Shtojca 4.4: Tabela e të dhënave të regjistrimit dhe ecurisë së studentëve në hyrje dhe dalje

	praktika profesionale dhe më pas për punësimin e tyre. Megjithatë, edhe këtu GVJ rithekson për një qasje sa më pozitive ndaj Sektorit të Bujqësisë, jo vetëm nga Institucioni, por nga gjithë aktorët e rëndësishëm në Rajon, Këshilli i Qarkut, dhe Bashkitë përkatëse (<i>shih</i> komentet në Standardin I.1, Kriteri 4).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përcënirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Institucioni angazhon studentët në organet vendimmarrëse dhe këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatorë të IAL-ve në fuqi (Shtojcat 1.11, 1.20, 3.3 dhe 3.4) ¹⁶⁵ . Nga intervistat me studentët, një pjesë pohojnë se përfaqësimi i tyre në këto struktura bëhet në përputhje me rregulloren e Këshillit Studentor (Shtojca 1.17), por GVJ konstaton se jo të gjithë ata kanë informacion të saktë mbi një përfshirje të tillë.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se në statutin e UNIKO (Shtojca 1.1) dhe në rregulloren e UNIKO (Shtojca 1.2) garantohej pjesëmarrja e studentëve në Senat në masën dhjetë përqind (të numrit të studenteve). Konstatohet se studentët kanë organizuar Këshillin studentor që vepron mbi bazën e një rregulloreje të posaçme (Shtojca 1.17). Një nga detyrat e Këshillit studentor, është dhe të koordinojë përfaqësimin e studentëve në organet drejtuese të UNIKO (Kreu 1, Shtojca 1.17).
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Nga intervistat me Përgjegjësin e DA dhe personelit akademik të Programit, pohohet se vetë njësi bazë po merr masat që në anketimin e ardhshëm të studentëve, të përfshihen pyetje vlerësuese për ngarkesën mësimore dhe aspekte të tjera të lidhura me programin e studimit në mënyrë që të arrihet një optimizim sa më i mirë i tij.

¹⁶⁵ Shtojca 1.11: Rregullore e senatit akademik të UNIKO; Shtojca 3.4: Lista e NJSBC; Shtojca 3.3: Vendimi i njësisë bazë për ngritjen e GVB; Shtojca 1.20: Kodi i etikës së UNIKO

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit si: Statuti i UNIKO (Shtojca 1.1), Rregullorja e Senatit Akademik (Shtojca 1.11) dhe Rregullorja e Brendshme e FB (Shtojca 2.2), konstatohet se këto struktura u japin mundësinë studentëve për përfaqësim të interesave të tyre në strukturat e UNIKO. Nga intervistat me studentët konstatohet se jo të gjithë ata kanë informacion të saktë mbi një përfshirje të tillë.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Gjatë intervistave, nga studentët u pohua se atyre u jepet mundësia e shprehjes mbi çështje që kanë të bëjnë jo vetëm me procesin mësimor, por edhe me atë të etikës në sjellje dhe komunikim, të ankimimit të rezultatit etj. Nga studentët u pohua se gjithmonë kanë pasur reagimin e duhur institucional dhe kanë gjetur mbështetjen e personelit akademik në rast kur haseshin problematika të caktuara. Studentët pohojnë se në çdo rast të ankimimit të procesit të vlerësimit, ata kanë gjetur mirëkuptimin dhe gadishmërinë e personelit akademik për sqarim të detajuar të vlerësimit të provimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi V.6</p>	
<p>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Rezulton se në Institucion funksionon me efektivitet të lartë QKA dhe zyra e Sekretarisë mësimore. Konstatohet se këto struktura kryejnë detyrat e tyre me korrektesë dhe përkushtim në drejtim të informimit të studentëve për çështje të ndryshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se QKA disponon një manual udhëzimi dhe informimi për studentët (Shtojca 3.11)¹⁶⁶. Këto struktura ushtrojnë veprimin e tyre mbi bazën e rregulloreve përkatëse, konkretisht Rregullore e sekretarisë mësimore të UNIKO (Shtojca 1.10) dhe Rregullore e drejtorisë së burimeve njerëzore, komunikimit dhe promovimit (Shtojca 1.4). Edhe nga studentët pohohet se ata marrin informacion të plotë sa herë që nevojitet nga strukturat e lartpërmendura.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Gjatë intervistave me përfaqësues të Qendrës së Karrierës dhe Alumni, pohohet se kjo strukturë informon mbi mundësitë për punësim apo zhvillimin e praktikave profesionale në mënyrë të vazhdueshme. Veç të tjerash, gjatë intervistave me studentët theksohet se kjo Qendër shërben për të informuar aplikantët për programet e ofruara. QKA mbështet integrimin e studentëve në universitet sipas Programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron</p>	<p>Nga intervistat me përfaqësues të QKA, pretendohet se ndërmerren</p>

¹⁶⁶ Shtojca 3.11: Praktika e informimit të studentëve me programin e studimit)



studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	kontakte me institucione të ndryshme dhe ndiqen problematikat lidhur me marrëdhëniet me biznesin, ofertat për punësimin e studentëve. Por GVJ nuk gjeti dokumenta evidentues të kësaj veprimtarie të QKA. Si pohohet dhe gjatë intervistave në shumë raste numri i studentëve pjesëmarrës në aktivitete apo që drejtohen për këshillim është mjaft i ulët.
---	--

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	GVJ konstaton se QKA ka ndërtuar një bazë të dhënash të studentëve që diplomohen në UNIKO me synim ndjekjen e punësimit të tyre deri në pesë vjet (Shtojca 4.6) ¹⁶⁷ . Rezulton se QKA aplikon një formular që plotësohet <i>online</i> për individët e diplomuar në programet e studimit që ofron institucioni, me qëllim gjurmimin e tyre për sa i përket të dhënave mbi punësimin. Konstatohet se numri i personave që e plotësojnë këtë formular është shumë i ulët, pavarësisht se nga përfaqësues të QKA u deklarua se Qendra këmbëngul në mënyrë të vazhdueshme duke bërë thirrje periodike nëpërmjet e-mailit. Edhe këtu ritheksojmë sa pohuam në Standrdin V.4, Kriteri 5 se duket se kjo mënyrë e ndjekjes së punësimit dhe e vlerësimit të tregut të punës nuk funksionon sa duhet. GVJ këshillon të gjenden mënyra të kombinuara për të gjetur qoftë kërkesat reale të tregut të punës, qoftë bashkëpunimet me bizneset e sektorit të bujqësisë në Rajon, dhe më gjerë në Shqipëri, për cilësinë e të diplomuarve, për praktika profesionale dhe më pas për punësimin e tyre. Megjithatë, edhe këtu GVJ rithekson për një qasje sa më pozitive ndaj Sektorit të Bujqësisë, jo vetëm nga Institucioni, por nga gjithë aktorët e rëndësishëm në Rajon, Këshilli i Qarkut, dhe Bashkitë përkatëse (<i>shih</i> komentet në Standardin I.1, Kriteri 4).
--	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁶⁷ Shtojca 4.6: Tabela përmbledhëse për punësimin e studentëve të programit të studimit

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Pas analizës së dokumentacionit dhe rregulloreve përkatëse (Shtojcat 1.1, 1.2 dhe 2.2) ¹⁶⁸ , GVJ konstaton se këto janë mbështetur në Ligjin 80/2015 dhe aktet e tjera që burojnë prej tij. Në bazë të Rregullores së FB (Shtojca 2.2), rezulton se ky Fakultet harton politika dhe procedura për SBC. UNIKO ka të miratur me vendim 300/2020 të Senatit Akademik, Manualin e Cilësisë së UNIKO (Shtojca 1.16), në të cilin sqarohen në detaje procedurat e SBC. Gjithashtu standardet për SBC hartohen nga njësi kryesore, në përputhje me Kodin e Cilësisë të hartuar nga ASCAL dhe MASR (Shtojca 2.2, Kreu XI, Neni 111).
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	FB ka njësinë e vet të SBC (Shtojca 3.27) ¹⁶⁹ , e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore. Kjo strukturë ka në përbërjen e vet përfaqësi nga çdo njësi bazë dhe 1 përfaqësues nga studentët. Konstatohet se NJSBC ushtron aktivitetin e saj në përputhje me Manualin e Cilësisë së UNIKO (Shtojca 1.16), dhe përpilon raporte periodike vjetore (Shtojca 3.7) ¹⁷⁰ . Gjatë intervistave me personelin, pohohet se këto raporte diskutohen në mbledhjet e personelit të DA dhe bëhen publike dhe në analizat vjetore të punës mësimore dhe kërkimore të UNIKO (Shtojca 3.29) ¹⁷¹ .
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Në Rregulloren e FB (Shtojca 2.2, Kreu XI, Neni 112) shpjegohet se Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. GVJ ka verifikuar dokumentin dhe konstaton se UNIKO ka kryer akreditimin Institucional nga ASCAL, me Vendimin të BA 65/2017 deri në 30/09/2022 (Shtojca 1.18) ¹⁷² . Ky Program është hera e parë që i nënshtrohet akreditimit nga ASCAL.

¹⁶⁸ (Shtojca 1.1: Statuti i UNIKO; Shtojca 1.2: Rregullore e UNIKO; Shtojca 2.2: Rregullore e Fakultetit të Bujqësisë)

¹⁶⁹ Shtojca 3.27: Të dhëna për NJSBC; Shtojca 3.4: Lista e NJSBC

¹⁷⁰ Shtojca 3.7: Raporti vjetor i NJSBC-së, Fakulteti i Bujqësisë

¹⁷¹ Shtojca 3.29: Analiza vjetore e UNIKO

¹⁷² <https://www.ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara>



<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Në RVB pohohet se cilësia dhe siguria monitorohet nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional (Shtojca 1.5)¹⁷³. Si del nga Raportet vjetore të UNIKO, DA dhe Raporti i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FB nga NJSBC¹⁷⁴ kjo merret në analizë për vit, ku bëhen konstatime të arritjeve në mësim dhe kërkim, evidentohen mangësi dhe shqetësime, dhe jepen këshillime dhe detyra për përmirësim në të ardhmen. Në RVB pohohet se në FB, DA dhe nga përfaqësues të Rektoratit organizohen kontrole për zbatimin e çdo programi mësimor. Për gjithë personelin akademik efektiv dhe me kontratë ka një Dosje e disiplinuar nga një Udhëzim¹⁷⁵ i posaçëm, që përmban informacion pranë zyrës së Burimeve Njerëzore dhe pranë DA, e cila ripërtërihet çdo vit (me Jetshkrimin, Syllabuset, Materialet Didaktike etj.)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kritere¹⁷⁴</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se UNIKO ka krijuar një strukturë të posaçme që është Drejtoria e kurrikulave, sigurimit të cilësisë dhe kërkimit shkencor, e cila funksionon mbi bazën e një Rregulloreje të dedikuar (Shtojca 1.5)¹⁷⁶. Në këtë Rregullore përcaktohen dhe detyrat e Sektorit të kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë (Shtojca 1.5, Kreu III, Neni 6) dhe në pikat 3 – 12 të këtij neni shprehet në mënyrë të qartë detyra e këtij sektori për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit etj.</p> <p>Bazuar në këtë dokumentacion, por dhe nga intervistat me Dekanin e FB, Përgjegjësia e DA dhe me personelin akademik të Programit të studimit, pohohet se vëmendje i kushtohet: rishikimit të shpërndarjes së krediteve për modulën apo grup - modulet përkatëse; rishikimit të programeve mësimore të moduleve të veçanta; rishikimit të elementëve përbërës të moduleve dhe ndarjen e kredive ndërmjet tyre (leksione, seminare, detyra, projekte, laboratorë etj); rishikimi i bazës së nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit,</p>

¹⁷³ + SHTOJCA 1.5 RREGULLORE E DREJTORISË SË KURRIKULAVE (NJSBC, QKA).PDF

¹⁷⁴ SHTOJCA 3.29 ANALIZA VJETORE UNIKO.pdf; SHTOJCA 3.7 RAPORTI VJETOR I NJSBC FAKULTETI I BUJQËSISË; SHTOJCA 3.8 ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË SË NJËSISË BAZË.pdf

¹⁷⁵ + SHTOJCA 1.14 UDHËZIMI PËR PËRMBAJTJEN E DOSJES SË STAFIT UK.PDF

¹⁷⁶ Shtojca 1.5: Rregullore për organizimin dhe funksionimin e drejtorisë së kurrikulave



	evidentimi i mangësive dhe marrja e masave për vitin pasardhës; rishikimi i literaturës së përdorur, mungesat e vërejtura dhe masat për përmirësimin e situatës; etj.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	GVJ konstaton se Institucioni disponon Manualin e cilësisë (Shtojca 1.16), në të cilin paraqiten mjaft qartë detyrat dhe organizimin e NJSBC, si dhe detyrat e të gjithë aktorëve të tjerë, si: Senati akademik, Bordi i administrimit, Këshilli i Etikës, Rektorati, Dekanati, njësia bazë, personeli akademik dhe ndihmësakademik, studentët etj., ku ndër detyrat themelore rezulton të jetë monitorimi i vazhdueshëm i Programit të studimit me qëllim optimizimin dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së tij.
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	GVJ pas takimeve me personelin akademik dhe analizës së Dosjes konstaton se Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e Programit të studimit. Në Rregulloren e FB (Shtojca 2.2), kreu IV, Neni 37, evidentohet qartë procedura e rishikimit të programeve të studimit nga Institucioni. NJSBC dhe zyra e Sekretarisë mësimore kontrollojnë në vazhdimësi ecurinë e procesit mësimor, duke regjistruar të gjitha mangësitë në zhvillimin e mësimin, të cilat bëhen objekt në procesin e rishikimit. Këto struktura funksionojnë pikërisht për të vlerësuar me parametra të matshëm ecurinë dhe mbarëvajtjen e Programit të studimit. Pjesë e këtyre vlerësimeve bëhen edhe pyetësorët studentorë (Shtojcat 3.13 & 3.14) ¹⁷⁷ .
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Pas shqyrtimit të RVB, por dhe pas takimit me përfaqësuesit e NJSBC dhe të Sekretarisë mësimore pohohet se të gjitha të dhënat e grumbulluara, ruhen në Arkivën e FB; në momentin e duhur rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për Programin e studimit. Por GVJ nuk disponon ndonjë dokument për të vlerësuar realisht efektivitetin e këtyre njësive.
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	GVJ në bazë të dokumenteve të analizuara (Shtojca 3.7) ¹⁷⁸ , konstaton se në mënyrë periodike, NJSBC harton Raportin e sigurimit të cilësisë. Nga intervistat me personelin, pretendohet se ky Raport diskutohet gjerësisht në mbledhjet e DA, në ato të FB, dhe në Senatin e UNIKO. Shumë elementë të këtij raporti, pasqyrohen dhe në Analizën vjetore të DA (Shtojca 3.8: Analiza vjetore e njësisë bazë) dhe në atë të UNIKO (Shtojcat 3.8 dhe 3.29) ¹⁷⁹ . Në këto Raporte janë përfshirë disa nga rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.

¹⁷⁷ SHTOJCA 3.13 MODEL PYETËSORI STUDENTOR.pdf; SHTOJCA 3.14 MODEL PYETËSORI I STAFIT AKADEMIK.pdf

¹⁷⁸ Shtojca 3.7: Raporti vjetor i NJSBC

¹⁷⁹ Shtojca 3.8: Analiza vjetore e njësisë bazë; Shtojca 3.29: Analiza vjetore e UNIKO

	<p>Duhet thënë se Raportet e analizës vjetore në Dosjen ASCAL, sidomos ai i NJSBC, përfshirë edhe vetë RVB, mund të strukturohen më mirë, më qartë, duke filluar nga përmbajtja dhe formatimi, duke evidentuar më qartë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikatat më të mira, qoftë për FB, për DA, apo për anëtarë të caktuar të personelit. Kjo do të ndihmonte realisht dhe konkretisht në gjithë procesin e përmirësimit të programit të studimit, dhe përpilimin e planit të masave përkatëse. Në Dosje janë edhe 2 pyetësorë për studentët (Shtojcat 3.13 & 3.14)¹⁸⁰. Jepet vetëm një model analize i zhvillimit të një moduli në fund (Shtojca 3.17)¹⁸¹. Nga studentët dhe nga intervistat me personelin akademik pohohet se ka vullnet nga ana e studentëve për plotësimin e pyetësorëve, por kjo nuk evidentohet në dokumentacion.</p> <p>Nuk del në gjithë këta Raporte se cilat janë konkretisht gjetjet, qoftë pozitive apo dhe negative, nga monitorimi i mësimdhënies nga DA, nga kontrollet e bëra nga Dekanati, nga mendimet e studentëve, apo nga vlerësues të jashtëm (p.sh. nga bota e biznesit bujqësor) etj. Këshillojmë, që këto të shqyrtohen me një frymë shumë më kritike dhe të nxirren arritjet rast pas rasti dhe mësimet e duhura për të ardhmen, pse jo dhe motivimi i më të mirëve.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.C	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se NJSBC harton raporte periodike në lidhje me sigurimin e cilësisë. Për procesin e akreditimit të këtij Programi studimi, kjo strukturë ka vënë në dispozicion Raportet vjetore të tri viteve të fundit (Shtojca 3.7) ¹⁸² . Nga këto raportime, konstatohet se NJSBC kujdeset që dokumentacioni i prodhuar të përputhet me standardet e kombëtare të cilësisë sipas cikleve të studimit. Të dhënat e këtij raportimi përfshihen në Raportin e vetëvlerësimit institucional dhe shërben si një bazë e rëndësishme

¹⁸⁰ SHTOJCA 3.13 MODEL PYETËSORI STUDENTOR.pdf; SHTOJCA 3.14 MODEL PYETËSORI I STAFIT AKADEMIK.pdf

¹⁸¹ SHTOJCA 3.17 MODEL ANALIZA NË PËRFUNDIM TË NJË MODULI.pdf

¹⁸² Shtojca 3.7: Raporti i NJSBC-së të Fakultetit të Bujqësisë

Alban Vllashi

<p>kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>për vetëvlerësimet pasardhëse. Evidentohet qartë nga përbërja e NJSBC (Shtojca 3.4)¹⁸³ se personeli akademik dhe studentët janë ata që marrin pjesë aktive në vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë dhe në hartimin e këtij raporti.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se NJSBC në bashkërendim dhe nën drejtimin e strukturave drejtuese të UNIKO ushtron aktivitetin e saj në përputhje me Rregulloren e drejtorisë së kurrikulave, sigurimit të cilësisë dhe kërkimit shkencor (Shtojca 1.5) dhe në përputhje me Manualin e cilësisë UNIKO (Shtojca 1.16), të gjitha këto në mbështetje të procesit të vlerësimit programor dhe institucional. Konstatohet qartë si nga shqyrtimi i dokumentacionit, ashtu dhe nga intervistat me përfaqësues të Drejtorisë së kurrikulave dhe me studentët, se para sezonit zhvillohen anketime me studentë në të cilat bëhen pyetje që kanë të bëjnë me shumë elementë të vlerësimit të mësimdhënies (Shtojca 3.13)¹⁸⁴.</p> <p>GVJ konstaton se numri i studentëve që i përgjigjen këtyre anketimeve është relativisht i ulët. Lidhur me komentet tona mbi cilësinë e raportimit shih edhe Standardin VI.2, Kriteri 5.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nga intervistat me personelin akademik dhe përfaqësues të Dekanatit të FB, pohohet se Institucioni aplikon metoda të drejtpërdrejta monitorimi në lidhje me vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimdhënies, shfrytëzimin e infrastrukturës së UNIKO në dobi të Programit të studimit, vlerësimin e bazës materiale të domosdoshme për seancat laboratorike etj. Pranohet nga vetë studentët dhe personeli akademik i Programit të studimit, se gjatë zhvillimit të praktikave profesionale, ata janë të shoqëruar dhe mbikëqyrur nga pedagogu udhëheqës. Por ndonjë mbikëqyrje me qëllim kontrollin në drejtim të cilësisë dhe realizimit të kësaj veprimtarie nuk evidentohet qartë.</p> <p>Po ashtu, DA kërkon përditësim të përvitshëm të Syllabuseve lëndore dhe bën verifikime të ndryshme për të siguruar përputhjen me Planin mësimor. Por GVJ konstaton se aplikimi i këtyre metodave të drejtpërdrejta, nuk dokumentohet qartë. Lidhur me komentet tona mbi cilësinë e raportimit shih edhe Standardin III.1, Kriteri 2, dhe Standardin VI.2, Kriteri 5.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të</p>	<p>GVJ konstaton se e vetmja metodë e tërthortë e matjes së cilësisë së programit të studimit janë vetëm rezultatet e vlerësimit nga studentët (Shtojca 3.13: Model pyetësori studentor). GVJ nuk arrin të evidentojë efektivitetin e kësaj metode vlerësimi, pasi rezultatet e pyetësorit</p>

¹⁸³ Shtojca 3.4: Lista e NJSBC

¹⁸⁴ Shtojca 3.13: Model pyetësori studentor




<p>tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>mungojnë.</p> <p>Ndërkohë konstatohet se, përsa i përket kualifikimit të personelit akademik, Departamenti kërkon përditësimin periodik (zakonisht vjetor) të jetëshkrimeve të tyre (Shtojca 2.9)¹⁸⁵.</p> <p>Lidhur me studimet periodike të tregut të punës, QKA ka ndërtuar një sistem database të studentëve që diplomohen (Shtojca 4.6) në UNIKO dhe institucioneve punëdhënëse, me synimin për të ndjekur punësimin e tyre dhe për të nxjerrë të dhëna mbi kërkesat e tregut të punës. Pohohet se kjo zyrë mban kontakte të vazhdueshme me studentët që frekuentojnë një program studimi me qëllim informimin e tyre mbi veprimtari të ndryshme që lidhen me aktivitetin mësimor. Gjatë intervistave, pohohet se QKA ndjek në tërësi problemet dhe problematikat e lidhura me marrëdhëniet me biznesin, ofertat për punësimin e studentëve dhe ndjek procesin e gjurmimit të tyre në lidhje me punësimin (Shtojca 4.6).</p> <p>Nga takimi me përfaqësues të QKA, pranë FB, GVJ konstaton se numri i studentëve të diplomuar që i përgjigjen pyetësorëve është shumë i pakët, dhe kësaj është i vështirë të kuptohet shkalla e punësimit të tyre. Duket se kjo mënyrë e ndjekjes së punësimit dhe e vlerësimit të tregut të punës nuk funksionon sa duhet. GVJ këshillon të gjenden mënyra të kombinuara për të gjetur qoftë kërkesat reale të tregut të punës, qoftë bashkëpunimet me bizneset e sektorit të bujqësisë në Rajon, dhe më gjerë në Shqipëri, për cilësinë e të diplomuarve, për praktika profesionale dhe më pas, me punësimin e të diplomuarve. Megjithatë, edhe këtu GVJ rithekson për një qasje sa më pozitive ndaj Sektorit të Bujqësisë, jo vetëm nga Institucioni, por nga gjithë aktorët e rëndësishëm në Rajon, Këshilli i Qarkut, dhe Bashkitë përkatëse (shih komentet në Standardin I.1, Kriteri 4).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e</p>	<p>GVJ konstaton se FB ka Njësinë e vet të SBC, e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore (Shtojca 3.7)¹⁸⁶.</p>

¹⁸⁵ Shtojca 2.9: Jetëshkrimet e stafit akademik

¹⁸⁶ Shtojca 3.7: Raporti vjetor i NJSBC-së

<p>aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Standardet për sigurimin e cilësisë hartohen nga UNIKO, në përputhje me Kodin e Cilësisë të hartuar nga ASCAL dhe MASR.</p> <p>Procesi i vlerësimit duhet të realizohet me përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Mirëpo GVJ konstaton se nuk janë të përfshirë mjaftueshëm për përditësimin e Programit edhe aktorët e tjerë të jashtëm, kompani, shoqata, etj. Kjo konsiderohet si mjaft e rëndësishme për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së Programit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Të gjitha strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, funksionojnë mbi bazën e rregulloreve të miratuara. Konkretisht Institucioni disponon dokumenta si: Statuti i UNIKO (Shtojca 1.1). Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO (Shtojca 1.2), Rregullore e Drejtorisë së kurrikulave (Shtojca 1.5), Rregullore e Këshillit të Etikës (Shtojca 1.20), Rregullore e Këshillit Studentor (Shtojca 1.21), Rregullore e FB (Shtojca 2.2), Rregullore e DA (Shtojca 2.3) dhe e Programit të studimit (Shtojca 2.5) etj. Në to sigurimi i cilësisë është pjesë themelore, si në drejtim të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe në drejtim të kualifikimeve shkencore dhe thellimit të kërkimit shkencor.</p> <p>Raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Lidhur me cilësinë e këtyre raportimeve përfshirë dhe atë të RVB në Dosje ritheksojmë të shihen komentet tona Standardin VI.2, Kriteri 5 dhe gjatë në këtë Raport.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në përputhje me Rregulloren e FB (Shtojca 2.2), sigurimi i brendshëm i cilësisë, ecuria e vlerësimit të cilësisë së Programit ndiqet nga DA dhe FB. Në këtë proces mbikëqyrjeje, vlerësimi dhe zbatimi i Programit të studimit, pjesë aktive është personeli akademik, ndihmës akademik e administrativ, si dhe studentët e Programit. Gjithashtu, edhe ngritja e GVB është një shembull tipik në këtë drejtim. Nga 4 anëtarë të GVB, 3 anëtarë janë pjesë e personelit akademik dhe 1 është përfaqësues i studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se në përputhje me Rregulloren e FB (Shtojca 2.2), DA është përgjegjës për krijimin dhe ofrimin e programeve në përputhje me rregullat që garantojnë cilësinë e detyrueshme. Përgjegjësi i Departamentit mbikëqyr të gjithë aktorët e brendshëm për të përmbushur standardet e cilësisë nën drejtimin e Dekanatit. Nga intervistat me personelin akademik / ndihmësakademik, administrativ dhe studentët e programit të studimit, GVJ konstaton se përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmang diskriminimet apo pabarazitë kundrejt personelit dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të</p>	<p>GVJ konstaton se ekzistojnë marrëveshje bashkëpunimi në</p>



brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	mbështetje të praktikave profesionale me institucione publike ose jopublike (Shtojca 2.10).			
	Por GVJ nuk mund të evidentojë përfshirjen e këtyre institucioneve në procesin e vlerësimit të brendshëm. Nga përfaqësues të institucionit pretendohet se në mënyrë të vazhdueshme bëhen konsultime me këta partnerë, por kjo nuk dokumentohet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton se në Planin strategjik të zhvillimit të UNIKO, 2016-2025 (Shtojca 1.3), janë të përshkruara politikat dhe procedurat që do të ndjekë institucioni gjatë gjithë kësaj periudhe. Personeli akademik dhe studentët pohojnë se ata informohen në mënyrë të vazhdueshme për veprimtari të ndryshme në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Ata informohen nëpërmjet sistemit elektronik të brendshëm. Por, GVJ konstaton se ky informacion nuk është i aksesueshëm nga jashtë <i>online</i> , pasi faqja zyrtare e internetit të UNIKO nuk është funksionale prej disa muajsh.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga shqyrtimi i RVB si dhe nga intervistat me personelin akademik dhe drejtues të dekanatit, pranohet se rezultatet e raporteve të gjeneruara nga strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë (Shtojca 3.7) ¹⁸⁷ janë diskutuar në Asamblenë e FB dhe më pas në Departament. Theksohet se diskutimet kanë respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin dhe rregulloren për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale (Shtojca 1.9).
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nga Raport analiza e NJSBC (Shtojca 3.7) konstatohet se në varësi të rezultateve të përfuara dhe problematikave të evidentuara, vijohet dhe me një plan masash të hartuara nga institucioni për zgjidhjen e tyre, në mënyrë që të rritet niveli i mësimdhënies/mësimnxënies dhe të thellohet kërkimi shkencor apo aftësitë me të cilat pajiset studenti.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë,	GVJ konstaton se UNIKO dhe FB, në mënyrë të përvitshme harton


¹⁸⁷ Shtojca 3.7: Raporti vjetor i NJSBC Fakulteti i Buqësisë

Alban V. Sato

në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>Raportet e veprimtarisë institucionale, të cilat përmbledhin analizën e procesit mësimor me të gjithë komponentët e tij, si dhe Raportin e analizës së kërkimit me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij (Shtojcat 3.8 dhe 3.9)¹⁸⁸. Këto analiza, diskutohen në shkallë të gjerë me pjesëmarrjen e personelit akademik dhe atij ndihmësakademik. Kjo pohohet nga personeli akademik i këtij programi studimi.</p> <p>GVJ konstaton se Institucioni organizon aktivitete periodike përfshirë mbledhjet e hapura të asamblesë të FB me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së Programit të studimit. Gjatë intervistave me personelin akademik ata pohojnë se janë pjesë aktive e veprimtarive të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë. Një pjesë e tyre janë dhe anëtarë të komisioneve përkatëse.</p> <p>Gjatë intervistave, nga studentët u pohua se atyre në mënyrë të vazhdueshme u bëhet thirrje për plotësimin e formularëve të vlerësimit, si dhe për evidentimin e problematikave të ndryshme që mund të hasin. Por GVJ konstaton se jo të gjithë ata kanë njohuri të plota për veprimtaritë që organizohen në kuadër të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu vërehet një indiferencë nga ana e studentëve për plotësimin e pyetësorëve të ndryshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë.</p> <p>Gjithësesi lidhur me qasjen ndaj sigurimit të cilësisë dhe cilësinë e raportimeve të cilët janë në Dosje, GVJ mendon se ka nevojë për përmirësim, që nga strukturimi, formatimi, qartësia e raportimit, dhe sidomos për më shumë frymë kritike në përmbajtje. Për këtë ritheksojmë të shihen komentet tona Standardin VI.2, Kriteri 5 dhe gjetkë në këtë Raport. GVJ konstaton se nuk del qartë sa janë ato publike, edhe për faktin se faqja zyrtare e internetit të UNIKO nuk është aktive.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

¹⁸⁸ Shtojca 3.8: Analiza vjetore e jesisë bazë; Shtojca 3.29: Analiza vjetore e UNIKO




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Inxhinieri agrare, Profili: Hortikulturë” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Fan S. Noli, Korçë”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi përgatit ekspertë të lartë me njohuri në hortikulturë (pemëtari, vreshta dhe luletari), dhe zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor, në përputhje me nevojat sot në sektorin e bujqësisë, sektor kryesor i zhvillimit ekonomik në Qarkun e Korçës, dhe në gjithë vendin.
2. Programi zhvillohet nga Departamenti i Agronomisë, Fakultetit i Bujqësisë, struktura dhe përvoja e të cilëve trashëgohet prej Institutit të Lartë Bujqësor (themeluar prej vitit 1971), shtyllë kryesore e vetë UNIKO, që nga themelimi i tij në vitin 1992. UNIKO kryen veprimtarinë në Qytetin e Korçës, qytet me tradita historike arsimdashëse.
3. Programi zhvillohet nga personel akademik dhe ndihmësakademik i kualifikuar dhe me përvojë të gjatë në fushën e bujqësisë, si në mësimdhënëse, në kërkim dhe në njohjen me praktikën më të mira në fushën e bujqësisë, dhe hortikulturës në veçanti.
4. Programi mbështetet nga një infrastrukturë mësimore dhe kërkimore e bollshme, e mirëmbajtur, mirëpajisur dhe funksionale, me salla leksionesh, seminaresh, me 9 laboratore, me një Ekonomi Didaktike Eksperimentale Bujqësore (EED; 19 ha) etj.
5. Programi mbështetet për zhvillimin e praktikave profesionale dhe punëve të diplomës edhe nga bashkëpunime me Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), Korçë. dhe me sipërmarrje të ndryshme me drejtim bujqësor në Qarkun Korçë.
6. Zhvillimi i Programit mbështetet mirë nga struktura ndihmëse akademike dhe administrative, dhe një Sistem Elektronik i Brendshëm (ESSE3) efektiv, i shpejtë dhe i saktë.

Pika të dobëta


1. Plani Mësimor ka disa mangësi në lidhje me VKM 41/2017 dhe më objektivat që ka një Master Profesional i tillë, si peshat e Lëndëve Bazë (A), peshat e Lëndëve Plotësuese (D) (Praktikë Profesionale), saktësimet në Detyrimet Përmbyllëse (E) ‘Tezë diplome/Provimi diplome’, në peshën e Leksioneve ndaj Praktikave laboratorike, mbingarkesëm e Lëndëve për semestër, saktësimet në Syllabuse, Literaturë etj.
2. Numri i personelit akademik jo i mjaftueshëm për zhvillimin normal të Programit: moshat mesatare relativisht të lartë, ngarkesa mësimore dhe numri i lëndëve të secilit relativisht të lartë, që bie ndesh me zhvillimin normal dhe vazhdimësinë e mësimdhënies.



3. Numri i personelit ndihmësakademik jo i mjaftueshëm për zhvillimin normal të Programit: 1 punonjëse ndihmëse, e cila është edhe në cilësinë sekretares së DA na duket pak, po të kemi parasysh se janë 9 laboratorë mësimorë dhe shkencorë, në të cilët zhvillohen paralelisht module laboratorësh nga lëndë të ndryshme.
4. GVJ konstaton se institucioni nuk mbështet financiarisht ndonjë pjesëmarrje në konferenca/simpoziume jashtë vendit, apo publikim shkencor ndërkombëtar.

Rekomandime

1. Plani Mësimor i Programit mund të përputhet me kërkesat e VKM 41/2017 dhe me objektivat që ka një Master Profesional, shumë prej tyre në përputhje me aktet tona ligjore, por dhe me përvojën e bollshme ndërkombëtare në rajon dhe më gjerë. Konkretisht: Lëndët Bazë (A) mund të kenë një vëllim prej 5%-10% (3-6 kredite); Praktika Profesionale mund të shkojë në 6 Kredite, 150 orë ose 6 javë punë; Provimi përfundimtar mund të shmanget si i tillë dhe të zëvendësohet vetëm me Mbrojtje Diplome nga secili student me 8 kredite, 200 orë ose 8 javë punë individuale; për disa lëndë të Planit Mësimor mund të rishihet pesha e leksioneve (nga 45 orë leksione në të shumtën 30 orë) në funksion të seminareve dhe sidomos të praktikave laboratorike. **Ne mbështesim zhvillimin e Programit me një Plan mësimor të tillë si shumë të dobishëm, por ndoshta kjo mund të kërkonte kohëzgjatje më të madhe, deri në 2 vite gjithsej, mbështetur kjo edhe në përvoja nga rajoni dhe më gjerë.**
2. Mund të rishihet numri i lëndëve dhe i ngarkesës së personelit akademik në përputhje me UO/MASR(2018), dhe mund të rekrutohet personel i ri i brendshëm (akademik dhe ndihmësakademik).
3. Vlerësimi i brendshëm i cilësisë dhe raportimi përkatës mund të jetë më i qartë në formatim dhe përmbajtje, në frymë kritike duke nxjerrë në pah pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikën më të mira për zhvillimin e Programit dhe përmirësimin e tij.
4. Departamenti duhet të rishohë mundësinë e zhvillimit të mësimin edhe në gjuhë të huaj, angleze, ose tjetër gjuhë me interes për tërheqjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.
5. Departamenti mund të përfshijë mjaftueshëm edhe aktorët e tjerë të jashtëm, kompani, shoqata, etj., për përditësimin e Programit, mjaft e rëndësishme kjo për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së Programit.
6. Testimi i njohurive, dijeve me shkrim mund të zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe të vihet në zbatim sistemi elektronik i testimit dhe vlerësimin të studentëve.
7. Departamenti mund këmbëngulë për përditësimin e literaturës në përdorim të Programit të studimit, cilësinë e fondit fizik dhe *online* në Bibliotekë, shkallën e shfrytëzimit të tyre nga personeli dhe studentët e Programit.
8. UNIKO, Fakulteti i Bujqësisë dhe Departamenti Agronomisë mund të bëjnë më shumë përpjekje që programe të tilla studimi me interes kombëtar të thithin studentë sa më




cilësorë. Kjo duke filluar nga faqja zyrtare e UNIKO deri te vendosja me përparësi nga UNIKO dhe MASR, e degëve të bujqësisë ndaj disa degëve të tjera, nga mbështetja me bursa studimi për kandidatë cilësorë (me mesatare të lartë) që vazhdojnë degët e bujqësisë, pse jo dhe motivimi më shumë i personelit etj.

9. UNIKO mund të bëjë përpjekje më shumë për sigurimin, mirëmbajtjen dhe pasurimin e vazhdushëm të faqes zyrtare të internetit (<https://www.unkorce.edu.al/>) me gjithë informacionin e mundshëm, nga Planet mësimore, Syllabuset, Jetëshkrimet e personelit, veprimtaritë e ndryshme etj. Marrja shpejt dhe saktë e informacionit nga jashtë, mund të ndihmojë më shumë në njohjen e programeve në Fakultetin e Bujqësisë, përfshirë dhe Programin nën shqyrtim, dhe në qëndrueshmërinë e tyre.
10. UNIKO mund të sanksionojë në Rregulloret përkatëse mënyrën e sigurisë/saktësisë së ruajtjes së sistemit të vlerësimit (notave), dhe parandalimin e gabimeve qoftë edhe njerëzore, dhe promovimin për auditimet me saktësi të lartë.
11. Të gjenden rrugët dhe mundësitë për të shëndosur gjendjen financiare në UNIKO dhe më gjerë në IAL-të e tjera publike.

**Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program
Professional Master "Agrarian Engineering, Profile: Horticulture" of
the Institution of Higher Education "Fan S. Noli University, Korça"**

Strengths and affirmations

1. The program prepares qualified experts with knowledge in horticulture (orchards, vineyards and floriculture), and sustainable agricultural development, in accordance with the today needs in the agricultural sector, the main sector of Korça's Region economic development and throughout the country.
2. The program is developed by the Department of Agronomy, Faculty of Agriculture, the structure and experience of which is inherited from the Higher Agricultural Institute (established since 1971), the main pillar of UNIKO itself, since its establishment in 1992. UNIKO operates in the city of Korça, a city with historical and educational traditions.
3. The program is developed by qualified academic staff and assistants with long experience in the field of agriculture, both in teaching, research and familiarity with best practices in the field of agriculture, and horticulture in particular.
4. The program is supported by an abundant teaching and research infrastructure, maintained, well-equipped and functional, with lecture halls, seminar classes, 9 laboratories, an Experimental Agricultural Didactic Economy (EDE; 19 ha) etc.




5. The program is supported for the development of professional internships and diploma theses also by collaborations with the Center for Transfer of Agricultural Technologies (QTTB), Korça, and with various enterprises in the field of agriculture in Korça Region.
6. The development of the Program is well supported by the academic and administrative support structure, and an effective, fast and accurate Internal Electronic System (ESSE3).

Weaknesses


1. The Curriculum has some shortcomings related to DCM 41/2017 and the objectives that a Professional Master has, such as the credit weight of Basic Courses (A), the weight of Complementary Courses (D) (Professional Practice), specifications in the Closing Obligations (E) 'Diploma Thesis / Diploma Exam', in the weight of Lectures on Laboratory Practices, overload of Courses per semester, corrections in Syllabuses, Literature, etc.
2. Insufficient number of academic staff for the normal development of the Program: relatively high average age, teaching load and the number of subjects, which contradicts the normal development and continuity of teaching.
3. Insufficient number of academic support staff for the normal development of the Program: 1 support staff, which is also in the capacity of DA secretary, seems a little number, if we consider that there are 9 teaching and scientific laboratories, in which modules are developed in parallel laboratories from different subjects.
4. EEG finds that the institution does not financially support any participation in conferences / symposia abroad, or international scientific publication.

Recommendation

1. The Curriculum of the Program can comply with the requirements of DCM 41/2017 and the objectives of a Professional Master, many of them in accordance with our legal acts, but also with abundant international experience in the region and beyond. Specifically: Basic Courses (A) can have a volume of 5% -10% (3-6 credits); Professional Internship can go up to 6 Credits, 150 hours or 6 weeks work; The final exam can be avoided as such and replaced only with Diploma Defense where each student can complete 8 credits, 200 hours or 8 weeks of individual work; for some subjects of the Curriculum the weight of the lectures can be revised (from 45 hours of lectures to a maximum of 30 hours) giving space to the seminars and especially laboratory practices. **We support the development of the Program with such a Curriculum as very useful, but perhaps this could require longer duration, up to 2 years in total, based on experiences from the region and beyond.**



2. The number of courses and the workload of the academic staff in accordance with U29 / MASR (2018) can be reviewed, and new internal staff (academic and academic support) can be recruited.
3. Internal quality assessment and related reporting can be clearer in format and content, in a critical spirit by highlighting strengths and weaknesses, as well as best practices for Program development and improvement.
4. The department should reconsider the possibility of teaching in foreign languages, English for example, or other languages of interest for attracting foreign students and internationalization.
5. The Department can sufficiently involve other external actors, companies, associations, etc., to update the Program, which is very important for ensuring and continuous improvement of the quality of the Program.
6. Testing of written knowledge can be done anonymously by secretation or codification and the electronic system of testing and evaluation of students can be implemented.
7. The Department may insist on updating the literature in use of the Study Program, the quality of the physical and online fund in the Library, the degree of their utilization by the staff and students of the Program.
8. UNIKO, the Faculty of Agriculture and the Department of Agronomy can make more efforts to ensure that such study programs of national interest attract high quality students. This starts from the official website of UNIKO to the placement with priority by UNIKO and MASR, of the branches of agriculture over some other branches, from the support with scholarships for quality candidates (with high average) who continue the branches of agriculture, why not and more staff motivation etc.
9. UNIKO can make more efforts for the provision, maintenance and continuous enrichment of the official website (<https://www.unkorce.edu.al/>) with all possible information, from the Curriculum, Syllabuses, CVs of staff, various activities, etc. Obtaining information quickly and accurately from abroad, can help more in recognizing the programs in the Faculty of Agriculture, including the Program under consideration, and in their sustainability.
10. UNIKO may sanction in the relevant Regulations the manner of security / accuracy of maintaining the evaluation system (grades), and the prevention of errors, even human, and the promotion of high-precision audits.
11. To find ways and opportunities to improve the financial situation in UNIKO and beyond in other public HEIs.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLEKËSIMI TËRËSOR				X

